



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 1 MARS 2013**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE  
KOSOVA, ODRŽANE 1 MARTA 2013. GODINE**

**MART - MART  
2013**

## **Rendi i ditës**

1. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të pestë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

## **Dnevni red**

1. Izveštavanje premijera Kosova, g. Hashim Thaçi, o njegovom petom susretu sa premijerom Srbije u Briselu

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së kryeministrit të Republikës, z. Hashim Thaçi.

E kemi vetëm një pikë të rendit të ditës. Të pranishëm janë 75 deputetë. Pika e vetme e rendit të ditës është:

### **1. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të pestë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel**

Kryeministri i Kosovës i është drejtuar kryetarit të Kuvendit me kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, më 1 mars 2013, në orën 19:30, për ta informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës për takimin e tij të pestë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel.

E ftoj kryeministrin që ta marrë fjalën.

HASHIM THAÇI, KRYEMINISTËR I KOSOVËS: Faleminderit, i nderuar kryeparlamentar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Duke e respektuar përgjegjësinë time kushtetuese dhe ligjore, dje, në pamundësi për të ju informuar, në pamundësi fizike do të thotë, nga pengesat fizike, unë i jam drejtuar Parlamentit të Kosovës, duke e përdorur autoritetin tim dhe të drejtën time kushtetuese dhe ligjore për seancë të jashtëzakonshme për sonte, në orën 19:30, që t'i informoj deputetët, Kabinetin qeveritar, të gjithë qytetarët e dashur të Republikës së Kosovës, opinionin publik për takimet e kaluara në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Por, është një seancë e jashtëzakonshme, pasi takimi tjetër mbahet të hënën dhe do të doja që patjetër të ju informoj paraprakisht.

Fillimisht, më lejoni që në emër të Qeverisë të ju uroj fëmijëve në incidentin në Pejë shëndet. I ftoj të gjithë autoritetet mjekësore që ta rritin kujdesin për ta, në mënyrë që këto shqetësime edhe të familjarëve të tyre, edhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës, institucioneve të Kosovës të tejkalohen sa më lehtë.

Në anën tjetër, ju e dini se dje, përkatësisht sot ka përfunduar edhe aplikimi për veteranët e luftës, verifikimi i tyre, familjet e tyre - familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Unë dua të ju siguroj të gjithëve se, është një mundësi e mirë të ju drejtohem, çdo aplikim do të shqyrtohet dhe çdo qytetar, që ka mbajtur armë në luftë për çlirimin e Kosovës, shenjën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ka luftuar për liri dhe pavarësi, do të jetë veteran, do të çmohet çdo familje e dëshmorëve dhe çdo invalid i luftës. Prandaj, unë nuk

do të lejoj që të ndahen luftëtarët e lirisë në asnjë rrethanë dhe në asnjë moment. Dhe, ne do të jemi shembull i botës së lirë, i suksesit në luftë, i unitetit në luftë dhe unitetit në paqe dhe integritet.

Prandaj, nuk do të lejojmë ndarje të tilla ideologjike apo partiake.

Besoj se sot zonjat dhe zotërinjtë e “Vetëvendosjes” nuk kanë marrë ndonjë pankartë apo ndonjë megafon, a ndonjë bilbil, megjithëse krejt janë bërë bilbila. Kështu që besoj që janë krijuar kushtet për të filluar.

I nderuari kryetar,  
Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në korrik 2010, për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës, u bë e qartë në spektrin ndërkombëtar se pavarësia e Kosovës është një fakt dhe si e tillë nuk është në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare.

Me këtë, u iniciua edhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e datës 9 shtator 2010, e cila e fton, si Kosovën, ashtu edhe Serbinë, që ta fillojnë një dialog teknik, si dy shtete të pavarura, për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Rezoluta, ndër të tjera, paraqet edhe synimet e dialogut për vendosjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, si dhe nëpërmjet këtij dialogu synohet promovimi i mëtejshëm i bashkëpunimit, arritja e progresit në procesin e integritetit evropian dhe përmirësimi i jetës së njerëzve.

Atëbotë, kur u nxor kjo rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, delegacioni i Kosovës, i kryesuar nga presidenti Sejdiu, kryeministri, pra unë, dhe ministri i Jashtëm, zoti Hyseni, kemi marrë pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së si mysafirë, pra Koalicioni PDK-LDK dhe të gjitha komunitetet tjera.

Ashtu siç jeni në dijeni dhe bazuar në informimet e rregullta që keni pranuar në vazhdimësi nga anëtarë të Qeverisë dhe personalisht unë, Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat e saj të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, e ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun teknik ndërshtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Këtë përgjegjësi, Qeveria e përmbush konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe në përputhje të plotë me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 18 tetor 2012, e cila e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta udhëheqë këtë proces.

Qëllimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të respektohet në tërësi obligimi ynë për ta implementuar Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për

normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Siç e dini, kjo rezolutë e obligon Qeverinë, respektivisht mua si kryeministër që të informojmë-raportojmë rregullisht në Kuvendin e Kosovës për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, gjë që edhe ka ndodhur rregullisht dhe jam mirënjohës për konstruktivitetin tuaj.

Pra, me plot përgjegjësi, Qeveria në gjithë procesin e këtij dialogu ka qenë e angazhuar, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ligjet në fuqi, në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe atë të Kuvendit të Kosovës.

Çdo marrëveshje e arritur është brenda kornizave të bazës ligjore të procesit të dialogut.

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit Kosovës dhe Serbisë është i një rëndësie të veçantë për shtetin e Kosovës dhe për rajonin e Ballkanit, në tërësi.

Është rruga më e mirë e mundshme për zgjidhjen e një mori çështjeve që kërkojnë qasje ndërshtetërore, rajonale dhe më gjerë.

Gjatë kësaj periudhe të dialogut, ne si Qeveri kemi arritur ndërmjet marrëveshjeve të arritura gjer më tani, që në masë të madhe ta përmirësojmë jetën e qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike, fetare apo politike, siç e përcakton edhe Kushtetuta jonë.

Për t'i përmendur disa përfitime, qytetarët tanë kanë qasje rajonale në procesin e vendosjes së kufijve shtetërorë në të gjitha pikat kufitare, është lehtësuar kalimi kufitar për të gjithë qytetarët, që i frekuentojnë pikat tona kufitare, diplomat e institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës po u shërbejnë bashkëkombësve, vëllezërve dhe motrave tona për avancime akademike dhe jetësore në trevat e tyre etnike dhe shumë çështje tjera.

Këto janë vetëm disa nga përfitimet e qytetarëve në këtë proces.

Synim dhe obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që drejtoj unë, dhe i tërë Kosovës, e këtu dua të besoj edhe juaji, të nderuar deputetë, është avancimi i shtetit të Kosovës dhe i subjektivitetit të saj ndërkombëtar, siç edhe e përcakton rezoluta e miratuar nga ju.

Ndërmjet këtij dialogu, Kosova synon që ta avancojë subjektivitetin e saj juridik karshi mekanizmave rajonalë dhe ndërkombëtarë, me theks të veçantë integrimet euroatlantike. Ndërmjet këtij dialogu, ndër të tjera, është mundësuar që Kosova të vendosë kontroll në të gjitha pikat kufitare, ku bazuar në sistemin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, policëve tanë dhe doganierëve të Republikës së Kosovës u është bërë e mundur dhënia e

kontributit të tyre në plotësimin e parakushteve për integritet euroatlantike, e po ashtu edhe në vendosjen e rendit dhe ligjit në disa pika problematike kufitare të Republikës së Kosovës.

Në proces të vazhdimit të dialogut, arritjes së marrëveshjeve dhe zbatimit të tyre është ndikuar në masë të madhe në stabilizimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Unë jam tejet i kënaqur që Kosova tani në procesin e shtet-ndërtimit është duke kontribuar në stabilizimin dhe ngritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Nga pranues i sigurisë dhe stabilitetit, Kosova gradualisht është duke u bërë faktor kontribuues i sigurisë dhe stabilitetit.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova që nga paslufta dhe në veçanti pas shpalljes së pavarësisë ka kultivuar dhe zhvilluar marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha vendet fqinje dhe të rajonit, duke u nisur nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, për të vazhduar me marrëdhënie të shkëlqyeshme me Slloveninë, Kroacinë, marrëdhënie të mira me Bosnjë-Hercegovinën, gjithashtu me Greqinë, Bullgarinë dhe me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet shteteve fqinje në rajonin tonë është parakusht për sigurimin e stabilitetit, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e përgjithshëm për një vend.

Para së gjithash, normalizimi i marrëdhënieve është një nga kushtet kryesore për integritetin evropian.

Konsideroj se normalizimi i marrëdhënieve edhe me Serbinë dhe vetë procesi i normalizimit të këtyre marrëdhënieve u kontribuon tri qëllimeve kryesore të shtetit të Kosovës:

1. Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërshtetërore shpie drejt njohjes së Kosovës, njohjes reciproke ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë, gjë që do të ndodhë në një moment të caktuar;
2. Qëllimi është arritja e marrëveshjeve për çështje praktike, të cilat mundësojnë funksionimin e plotë të shtetit të Kosovës sipas Kushtetutës sonë;
3. Proces i dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë i hap Kosovës perspektivë të sigurt për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Së pari, fillimi i procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dy shteteve të pavarura, ka synimin e mbylljes së kapitullit të errët të së kaluarës dhe hapjen e kapitullit të paqes, bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe integriteteve euroatlantike.

Ne si Qeveri e Republikës së Kosovës e kemi bërë të qartë gatishmërinë për fqinjësi të mirë edhe me Serbinë, përkundër historisë armiqësore dhe gjenocidit të shtetit serb ndaj shqiptarëve.

Në harmoni me Kushtetutën e Kosovës, e kemi shprehur gatishmërinë për ta hapur kapitullin e paqes, duke e vënë prapa historinë, por duke mos e harruar asnjëherë.

Prandaj, duhet ta pranojmë faktin se Serbia ende nuk e ka njohur shtetin e Kosovës. Mirëpo, ne jemi të bindur se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore shpie drejt këtij përfundimi logjik - pra të njohjes së Kosovës, njohjes reciproke, që do të mund të ndodhë.

Të gjithë e dimë se në BE nuk mund të hyjmë pa i plotësuar kushtet që lidhen me funksionimin e sistemit të brendshëm të shtetit në gjithë territorin, funksionimin e rendit kushtetues dhe ligjor, kontrollimin e kufirit, funksionimin e sistemit të vetëm gjyqësor, policor e doganor dhe çështje tjera.

Dialogu dhe marrëveshjet me Serbinë i kanë kontribuar dhe po i kontribuojnë shtrirjes së sovranitetit dhe rendit ligjor në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit Ndërshtetëror ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Marrëveshja e IBM-it), marrëveshje që lidhet me zhbërjen e strukturave paralele të sigurisë, të atyre të doganave dhe marrëveshjet tjera sigurojnë vendosjen e rendit kushtetues dhe ligjor në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Me këto marrëveshje e ndalojmë kontrabandën në vendkalimet kufitare në veri dhe mundësojmë stabilizimin e tregut të vendit, ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe ofrimin e mbrojtjes institucionale për tregtinë e ligjshme.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të krijojë mundësi reale dhe të shpejta për Kosovën për anëtarësim në OKB, në BE, në NATO dhe në mekanizma tjerë ndërkombëtarë.

Dialogu, së bashku me reformat evropiane, të cilat i kemi realizuar me sukses si institucione të Kosovës, ka bërë që Kosova të jetë sa më afër BE-së dhe NATO-s.

Kosova tashmë e ka hapur kapitullin e marrëdhënieve zyrtare me Bashkimin Evropian, duke hyrë në procesin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërsa me të drejtë presim

nga BE-ja liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të cilët padrejtësisht kanë mbetur më të izoluarit në rajon.

Ne kemi marrë përsipër dhe kemi punuar pandërprerë për plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura nga Komisioni Evropian nëpërmjet udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave.

Qëndrimi konstruktiv i Qeverisë së Republikës së Kosovës në procesin e dialogut e ka përmirësuar dukshëm imazhin e shtetit të Kosovës para Bashkimit Evropian, si dhe ka bërë që pesë vendet e Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës të votojnë pro vendimeve të Bashkimit Evropian për avancimin e integritetit evropian për Kosovën.

Vendimi për fillimin e negociatave për hyrjen në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së pritet të jetë hapi i ardhshëm, të cilin Bashkimi Evropian do ta realizojë ashtu siç edhe ka premtuar.

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Janë mbajtur një mori takimesh, që nga 8 marsi i vitit 2011 e deri më tani, si në nivel teknik, e po ashtu janë mbajtur edhe pesë raunde të takimeve në nivel të kryeministrave në kuadër të procesit, për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Janë arritur disa marrëveshje kornizë e shumë konkluzione tjera përcjellëse të marrëveshjeve.

Ekipe të shumta janë përfshirë në këtë proces, analiza, dialogim, zbatim, mbikëqyrje e zbatimit, koordinim me partnerët dhe aleatët, e shumë e shumë angazhime të tjera.

Më lejoni të jua jap një pasqyrë të përgjithshme.

U nevojitën pesë raunde dhe më se pesë muaj negociata të vazhdueshme, që nga 8 marsi e deri më 2 korrik 2011 që të arrihen marrëveshjet e para.

Kjo tregon për ngurtësinë e palës serbe në fillim të dialogut dhe qëndrimet diametralisht të kundërta ndërmjet palëve.

Më 2 korrik u arritën tri marrëveshje, ajo për lirinë e lëvizjes, për regjistrin civil, dhe ajo për diplomat universitare. Pra, ky rund ka bërë të mundur që të thyhet tabuja e lëvizjes njëdrejtimshe dhe pamundësisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës ta shfrytëzojnë mundësinë për qasje në vendet e rajonit dhe nëpërmjet territorit të Serbisë.

Po ashtu, ka bërë të mundur që gradualisht qytetarët e Republikës së Kosovës të komunitetit serb të pajisen me dokumente zyrtare të Republikës së Kosovës, e deri më tani më shumë se 8 000 automjete në pronësi të qytetarëve serbë janë pajisur me



dokumentet e nevojshme të regjistrimit të lëshuara nga institucionet legjitime të Republikës së Kosovës.

Ngjashëm ka ndodhur edhe me dokumentet e udhëtimit, tabelat e makinave dhe regjistrimet.

E kemi vendosur një mekanizëm të rregulluar të sigurimeve reciproke të automjeteve, nga një kaos total, ku Banka Qendrore e Kosovës duhej t'i mbulonte shpenzimet e mos-sigurimeve të automjeteve me targa serbe. Tani më e kemi një regjim të rregulluar dhe jemi duke punuar që byroja jonë të nënshkruajë marrëveshje me byronë homologe të Serbisë, që të ulen çmimet, dhe në të njëjtën kohë jemi duke punuar për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrosë së Kartonit të Gjelbër.

Në anën tjetër, marrëveshja për regjistrin civil ka bërë të mundur kthimin e regjistrave civilë të marrë padrejtësisht nga Serbia, e po ashtu ka bërë të mundur të plotësohet një standard i rëndësishëm së veçantë në procesin e liberalizimit të vizave.

Më 2 shtator 2011 janë konkluduar marrëveshjet për vulat doganore dhe kadastrat.

Edhe në këto marrëveshje, siç edhe jeni të informuar, janë arritur objektivat e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në njohjen nga Serbia të një elementi shumë të rëndësishëm të shtetësisë së Kosovës, siç është sistemi unik doganor i Republikës së Kosovës dhe institucionit të doganave të Republikës së Kosovës, në përgjithësi.

Kjo marrëveshje ka bërë të mundur që transporti i mallrave të mos jetë njëdrejtimësh, por edhe mallrat kosovare të mund të kenë qasje në tregjet serbe.

Po ashtu, me këtë marrëveshje janë vendosur bazat e një menaxhimi të integruar të kufijve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Në anën tjetër, është bërë e mundur të kthehet dokumentacioni kadastral i Kosovës, i marrë padrejtësisht nga Serbia pas luftës.

Kjo marrëveshje përfundimisht mbyll ekzistimin dhe funksionimin e qendrave ilegale paralele të kadastrës, që funksionojnë në Serbi.

Po ashtu, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje mundësohet që ta kemi një sistem kadastral të kompletuar dhe të besueshëm konform standardeve evropiane.

Për më tepër, kjo marrëveshje është në interes të qytetarëve dhe të shtetit, sepse riparohen dëmet e krijuara nga lufta në këtë fushë, duke mundësuar zgjidhjen e kontesteve pronësore të pronave private dhe publike në Republikën e Kosovës.

Më 21 nëntor 2011 është bërë e mundur që diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Kosovës të njihen në Serbi, duke e hequr praktikën e certifikimit nga UNMIK-u. Po ashtu, me këtë marrëveshje hapen mundësitë për punësim dhe arsimim

të mëtejme për qytetarët, dhe në veçanti për shqiptarët e Luginës së Preshevës, gjë e cila mundëson heqjen e një pengese për qëndrimin e tyre në trojet shqiptare.

Më 30 nëntor 2011 është arritur marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, marrëveshje e cila pason diskutime shtesë për zbatimin e saj dhe arrin të funksionalizohet më 10 dhjetor të vitit 2012, kur edhe fillojnë dy pikat e para kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë së funksionuari.

Gjer më tani janë hapur katër pikat kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe dje, më 28 shkurt, edhe dy pikat e fundit, dy pikat e mbetura, të parapara me marrëveshje. Pra, marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ka filluar së implementuari në tërësi.

Të gjitha përgatitjet janë bërë dhe jemi shumë konfidentë që funksionalizimi i tyre do të jetë në funksion të lehtësimit të kalimit të qytetarëve dhe mallrave të të dyja shteteve.

Sa i përket çështjes së IBM-it, siç edhe ju kam informuar më 16 nëntor 2012, dhe informimet tjera që keni pranuar, zbatimi i kësaj marrëveshjeje bëhet duke e përmirësuar dhe adoptuar infrastrukturën ekzistuese në sistemin e IBM-it deri në ndërtimin e pikave kufitare të përhershme, që do të bëhet nga Bashkimi Evropian.

Bashkimi Evropian tani e ka përzgjedhur një kompani për ta kryer fizibilitetin dhe përgatitur propozimin se si do të duken objektet e IBM-it në pikat e kalimit kufitarë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Dhe, jemi konfidentë se këto pika do të ndërtohen sipas standardeve evropiane në kohën e përcaktuar me marrëveshje.

Në maratonën e takimeve, të mbajtura prej 21 deri më 24 shkurt, është arritur marrëveshja për bashkëpunimin rajonal, marrëveshje e cila ka për synim funksionalizimin e shtetit të Kosovës dhe mënjanimin e të gjitha pengesave të Serbisë në pjesëmarrjen e Kosovës në iniciativat rajonale.

Po ashtu, në këtë fushë synojmë që të rrisim pjesëmarrjen e Kosovës në aktivitete ekonomike, rajonale, që i hapin rrugë zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas vizitave që i bënë Republikës së Kosovës dy nga personalitetet më eminente të politikës botërore, si ish-sekretarja e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Klinton dhe zëvendëspresidentja e Komisionit Evropian dhe njëherësh përfaqësuese e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baronesha Eshton, në fund të tetorit të 2012, dhe konsultimeve me gjithë spektrin politik vendor dhe aleatet tanë, dhe pas miratimit të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës për fillimin e procesit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 18 tetor 2012, unë si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i autorizuar nga ju, deputetë të nderuar, kam udhëtuar në Bruksel për të marrë pjesë në takimin e parë të nivelit të lartë

politik ndërmjet dy kryeministrave të ndërmjetësuar nga baronesha Eshton dhe të përkrahur fuqimisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Që nga fillimi i këtij procesi e deri më sot, kur po raportoj para jush dhe përpara qytetarëve të Kosovës, ne kemi mbajtur pesë runde të takimeve në këtë nivel të lartë.

Në këto takime janë diskutuar tema të shumta, me ndikim të madh për të ardhmen e dy vendeve fqinje, por pa e harruar kurrë tmerrin dhe dhimbjen e shkaktuar nga Serbia.

Vuajtjet dhe sakrificat tona kanë qenë dhe do të vazhdojnë të jenë motivi ynë për të lëvizur sa më shpejt përpara drejt integritit në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Takimi i parë ka ndodhur më 18 tetor 2012. Në këtë takim janë ngritur disa çështje nga baronesha Eshton dhe janë diskutuar nga dy kryeministrat: i shtetit të Kosovës dhe të Serbisë.

- Zbatimi në praktikë i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë;
- Zbardhja e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës,
- Zhbërja dhe largimi nga Kosova i strukturave paralele të financuara nga Serbia,
- Mospengimi i Kosovës për anëtarësim në organizatat dhe forumet ndërkombëtare,
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë,
- Përmbyllja e procesit të decentralizimit në Kosovë, që nënkupton domosdoshmërinë e formimit të komunës së re, atë të Mitrovicës së Veriut dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira në veri të vendit,
- Arritja e marrëveshjeve në fushën e telekomunikacionit dhe energjisë, sipas standardeve evropiane,
- si dhe mundësinë e shpejtë të hapjes së zyrave ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Beograd dhe anasjelltas të Serbisë në Kosovë.

Nga ky takim i parë u konkludua mirëkuptimi dhe pajtimi për t'i adresuar temat e diskutuara dhe vazhdimi i takimeve të tjera.

Takimi i dytë:

Më 7 nëntor u mbajt takimi i dytë i radhës në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Në këtë takim është shënuar progres konkret, sidomos në çështjen e zbatimit në praktikë të marrëveshjes teknike për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Në këtë takim u vendos metodologjia substanciale e funksionimit të IBM-it, siç edhe e theksova më lart, fillimi i zbatimit të tij më 10 dhjetor të vitit 2012 në dy pikat e para dhe përfundimi i fazës së përkohshme më 28 shkurt, kur edhe u përmbyll në të gjitha pikat.

Me rëndësi është që kjo marrëveshje në aspektin e menaxhimit të kufijve ndërmjet shteteve tona është në tërësi ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Serbisë, pasi EULEX do të jetë i pranishëm karshi mandatit të garantuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Po ashtu, edhe në këtë takim është diskutuar përsëri çështja e personave të zhdukur.

Kjo çështje është diskutuar edhe në takimet e mëparshme, dhe është ngritur nga unë vazhdimisht, dhe do të vazhdoj ta ngre këtë çështje derisa të përmbyllet ky proces. Kemi përmendur dhe do të propozojmë edhe zyrtarisht emërimin e ndonjë emisari special, që do të merret për këtë çështje të ndjeshme, gjithmonë me mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me një presion që mund t'u bëhet autoriteteve të Beogradit, që kjo çështje të zgjidhjet njëherë e përgjithmonë.

Jemi pajtuar që edhe kjo çështje humane dhe shumë e dhimbshme duhet të zgjidhet patjetër sa më shpejt.

Pika e tjetër e diskutuar ka qenë edhe nevoja e hapjes së zyrave ndërlidhëse ndërmjet dy shteteve tona.

Duhet ta pranojmë faktin se Serbia ende nuk e njohur shtetin e Kosovës, siç theksuam më lart, mirëpo ne jemi të bindur se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore shpie drejt këtij përfundimi logjik - pra të njohjes së Kosovës, njohjes reciproke që do të mund të ndodhë.

Pavarësisht këtij fakti, për shkak të nevojave të shumta që kanë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Serbisë, dhe me qëllim të krijimit të kanaleve zyrtare të komunikimit ndërshtetëror për t'i adresuar problemet e ndryshme, është shumë logjike dhe praktike që Republika e Kosovës ta hapë Zyrën Ndërlidhëse në Beograd dhe të njëjtën gjë ta bëjë edhe Serbia në Prishtinë.

Siç jeni të informuar, ne tashmë e kemi emëruar të dërguarin tonë për të udhëhequr Zyrën Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Beograd. Ai është ambasadori, zoti Lulzim Peci.

Në këtë fazë, grupet teknike ndërshtetërore me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian janë duke i adresuar të gjitha detajet që ndërlidhen me funksionimin e këtyre zyrave ndërlidhëse, të cilat në këtë fazë fillestare fizikisht do të jenë të vendosura në ndërtesat e Misionit të BE-së në Beograd dhe në Prishtinë.

Çështje tjetër, që është diskutuar në takimin e dytë, ndërlidhet me domosdoshmërinë e transparencës së Serbisë për financimin e sektorëve të ndryshëm në Kosovë, e me theks të veçantë, financimin e strukturave paralele të sigurisë në veri të vendit.

Ju e dini se ndalimi i financimit dhe zhbërja e strukturave ilegale të sigurisë së Serbisë që funksionojnë ende në veri të vendit është çështja kryesore dhe më e rëndësishme që ndërlidhet me këtë proces.

Për më tepër, ky është kushti kyç që Serbia duhet ta përmbushë në raport me Bashkimin Evropian, për të bërë progres drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian.

Ndërsa tashmë është e qartë se Serbia nuk do të mund bëjë progres drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian pa i plotësuar të gjitha kushtet e vëna në raport me Kosovën.

Po ashtu, në këtë takim është diskutuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e fetare dhe për mundësinë për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Merdar-Nish apo Prishtinë-Mutivodë-Leskoc, me financimin e Bashkimit Evropian, që e lidh Republikën e Kosovës me korridorin evropian.

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Takimi i tretë:

Më 4 dhjetor 2012, në nivel të kryeministrave edhe në këtë takim u diskutuan pikat ende të papërfunduara nga takimi i dytë, me theks të veçantë IBM-i dhe zyrat ndërlidhëse ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Takimi i katërt:

Më 17 janar 2012, kur është biseduar për zhbërjen e strukturave ilegale të sigurisë së Serbisë në Kosovë, për përmbylljen e plotë të Marrëveshjes së IBM-it, në veçanti në fushën e Doganave, si dhe për veprimet që do të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit në pjesën veriore të vendit tonë.

Në kuadër të angazhimeve tona për integrimin e pjesës veriore në institucionet e Kosovës, gjatë këtij takimi jemi pajtuar gjithashtu për themelimin e Fondit zhvillimor për pjesën veriore të Kosovës.

Këtë fond do ta udhëheqin: një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës; një përfaqësues i komunitetit serb dhe përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, përkatësisht zoti Zhbogar. Ky fond do të shërbejë si një katalizator i përmirësimit të infrastrukturës së përgjithshme në atë pjesë dhe investimet që do të bëhen nga mjetet e këtij fondi do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve në atë pjesë të Kosovës.

Mjetet që do të derdhen në këtë fond do të rrjedhin, e ritheksoj, nëpërmes Thesarit të Kosovës dhe në fond do të mund të kontribuojnë edhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Takimi i pestë:

Më 19-20 shkurt 2013, ashtu siç jeni në dijeni, javën e kaluar, pra më 19 dhe 20 shkurt, në Bruksel, u mbajt raundi i pestë i negociatave ndërmjet delegacionit të Republikës së Kosovës dhe atij të Serbisë me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, në kuadër të procesit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Unë si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës tashmë e kam informuar Presidenten e vendit, Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është informuar në detaje gjithashtu edhe nga koordinatori politik dhe kam diskutuar edhe me liderin e AAK-së. Gjithashtu, të gjitha komunitetet dhe të tjerët, që kanë qenë të interesuar të informohen.

Por, në të njëjtën kohë, më lejoni që të ju informoj edhe ju, deputetë të nderuar, duke u nisur nga obligimet e mia kushtetuese, ligjore dhe nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rundi i pestë i bisedimeve ka qenë më dinamik dhe ka zgjatur dy ditë.

Temë kyçe e këtij takimi ka qenë shpërbërja e strukturave paralele ilegale të sigurisë në veri të vendit dhe ndalimi i plotë i financimit të këtyre strukturave nga Serbia.

Unë mund të ju them me përgjegjësi të plotë se Serbia në takimin e fundit të zhvilluar në Bruksel, është pajtuar, së paku verbalisht, që të heqë dorë nga përkrahja, organizimi dhe financimi i strukturave ilegale në veri të vendit.

Kryeministri i Serbisë, Daçiq, është zotuar se do ta përmbushë një obligim të tillë, pavarësisht se a do të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse në fund të procesit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.

Unë nuk impresionohem nga fjalët e tij dhe pres që veprimet konkrete në këtë drejtim të ndodhin në terren në ditët dhe javët në vazhdim, siç nuk impresionoheni as ju. Prandaj, ne në takimin e ardhshëm presim që të përcaktojmë afate kohore konkrete për zhbërjen e plotë të tërësishme të strukturave ilegale të Serbisë, me theks të veçantë të atyre në fushën e sigurisë e të drejtësisë, të instaluar tash e 13 vjet.

Ne gjithashtu, në takimin e radhës, që do të mbahet më 4 mars, presim që t'i përcaktojmë detajet tjera për themelimin e mekanizmit implementues të marrëveshjeve të arritura dhe që do ta kenë rolin kyç në zbatimin e të gjitha marrëveshjeve në praktikë.

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Së paku verbalisht edhe Serbia është pajtuar se do të funksionojë sistemi i vetëm unik i drejtësisë, sipas ligjeve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Një çështje tjetër e rëndësishme, që është diskutuar gjerësisht gjatë këtij takimi, ka të bëjë me normalizimin politik në pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe integrimin e kësaj pjese në institucionet legjitime të Kosovës, në nivelin lokal dhe në nivelin qendror.

Kjo çështje, siç edhe e dini, është jashtëzakonisht komplekse dhe ka në vete disa komponentë, e që natyrisht thelbësore do të jetë organizimi apo domosdoshmëria e organizimit të zgjedhjeve të lira lokale dhe regjistrimi civil i popullsisë për atë pjesë.

Lidhur me mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve lokale në katër komunat veriore të Kosovës mund të ju them se ka një pajtueshmëri absolute ndërmjet palëve të përfshira në dialog.

Natyrisht, që ne jemi treguar pragmatikë në qasjen tonë, duke e pranuar faktin se këto zgjedhje lokale, që duhet të mbahen, mund të organizohen nga aspekti teknik nga një organizatë ndërkombëtare, që në rastin tonë do të jetë OSBE-ja. Pra, institucionet e Republikës së Kosovës do t'i bëjnë ftesë OSBE-së që t'i organizojë dhe menaxhojë zgjedhjet në këto katër komuna. Ndërsa, s'ka dyshim që zgjedhjet do të mbahen plotësisht në përputhje me ligjet e Kosovës dhe ato do të certifikohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Një element tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm, që është diskutuar gjatë takimit të javës së kaluar, ndërlidhet me propozimin për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Unë dua të sqaroj qartë për ju, të nderuar deputetë, dhe për të gjithë qytetarët e dashur të Republikës së Kosovës, se themelimi i një mekanizmi të tillë është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke u bazuar gjithmonë në dokumentin bazë ndërkombëtar dhe përgjegjësinë që kemi marrë ne, me dokumentin e presidentit Ahtisaari, pra prej atij dokumenti bazë, që e shpallëm pavarësinë e Kosovës, më 17 shkurt 2008. Një dokument, të cilin e kemi aprovuar të gjithë në vitin 2007, si Kuvend. Natyrisht, ata që kanë qenë pjesëmarrës atëbotë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Një mekanizëm i tillë, që do të themelohet, nuk do të ketë rol legjislativ dhe as ekzekutiv. Dhe, këtu e heq çdo dilemë! Ju siguroj dhe garantoj!

Pra, nuk mund të jetë zëvendësim për kuvendet komunale dhe përgjegjësitë e komunave nuk mund të barten te ky mekanizëm.

Unë dhe Qeveria që e udhëheq, së bashku me ju, nuk do të lejojmë formimin e një niveli të tretë të pushtetit në Kosovë, por të jem shumë i sigurtë me ju, edhe ju me mua në të njëjtën kohë, as unë, as ju, nuk mund ta ndalojmë Serbinë që të ëndërrojë për një plan të tillë. Por, e di se bashkërisht nuk do të lejojmë realizimin e asaj ëndrre, mund të them lirisht - milosheviqiane në Republikën e Kosovës, dhe kjo nuk do të ndodhë.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Gatishmëria e Kosovës për të hyrë në dialog për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe qasja jonë konstruktive e kanë krijuar një vlerë të re për shtetin e Kosovës në aspektin e vendosjes së rendit dhe ligjit, e po ashtu edhe në planin e politikës së jashtme, e cila do të shfrytëzohet për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtarë të Kosovës.

Në anën tjetër, Bashkimi Evropian e ka siguruar Qeverinë e Republikës së Kosovës se dialogu do t'i shërbejë Kosovës për të avancuar në procesin e integrimi evropiane.

Si rrjedhojë e përmbushjes së kriterëve evropiane, Kosova është në rrugë të mirë që sivjet ta nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim-Associmit dhe po ashtu të përfitojë nga liberalizimi i vizave.

Ngjashëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e mbështetin fuqishëm këtë proces dhe janë pjesë substanciale aktive dhe dinamike e tërë këtij procesi, që zhvillohet në Bruksel.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë jam kryeministër i Kosovës, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga qytetarët e Kosovës dhe i votuar edhe nga ju, shumica.

Unë edhe me qëndrimet e mia të mëhershme, në fillim të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e kam thënë dhe po e përsëris edhe sot, se këto takime që po zhvilloj unë së bashku me Kabinetin qeveritar, së bashku me koordinatorin politik, të cilin dëshiroj ta falënderoj edhe nga kjo foltore, zotin Shala, për ndihmesat, këshillat, rekomandimet dhe gjithë përgjegjësitë shtetërore që po tregohen, mund të ju siguroj se ne do të punojmë me këmbëngulje të gjithë në mënyrë unike, megjithëse jam shumë i bindur se këto rrethana, këto takime, këto procese nuk janë fare populliste dhe jam i vetëdijshëm se nuk sjellin vota. Por, në të njëjtën kohë, edhe akuzat e paqëndrueshme, të drejtuara ndaj këtij procesi, të jeni të bindur se nuk do t'i sjellin vota askujt. Përkundrazi, votat fitohen duke punuar për shtet.

Përkundrazi, këto takime janë të rënda. Ju them sinqerisht, përsëri edhe për mua, edhe për të gjithë njerëzit që janë aty. Por, jam i bindur se këto takime të rënda dhe të vështira janë



të dobishme për konsolidimin dhe forcimin e shtetit tonë. Janë në interesin e shtetit dhe atdheut tonë të përbashkët, Kosovës së re demokratike dhe evropiane.

Prandaj, unë mbetem i përkushtuar dhe i gatshëm të mbetem pjesë e këtij procesi të vështirë, i gatshëm të marrë vendime të vështira, por gjithmonë në interes të shtetit, duke i vënë interesat partiake në interes të shërbimit në emër të shtetit.

Pra, ju siguroj se do të marrim vendime që do të jenë plotësisht në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe me dokumentin e presidentit Ahtisari. Një rrethanë e re kjo, që do të krijojë kushte edhe më të mira, edhe më të shpejta për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Dhe, tani deputetë të nderuar, shumë të vlerësuar,  
Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ka pasur opinione të ndryshme këto ditë, kur është folur për ndarje të Kosovës, për autonomi të serbëve, për model të republikës serbe, për status special, për shkëmbim territoresh, për modelet e Tirolit, e ku ta di, të Katalonisë, për Ahtisari +, e shumë e shumë ide. Nuk e di edhe prej nga po vinë, por sido që të jetë janë dëgjuar dhe mirë që po dëgjohen. Por, unë dua të ju siguroj juve, deputetë të nderuar, gjithë spektrin politik kosovar, ju të përfaqësuar në Kuvend dhe spektri politik i papërfaqësuar ende në Kuvend, dua ta siguroj shoqërinë civile, dua t'i siguroj familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e UÇK-së, dua t'i siguroj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, kudo që jetojnë: në Kosovë dhe në Diasporë, dua t'i siguroj të gjithë shqiptarët se nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe as që është duke kërkuar diçka të tillë ndokush, se nuk do të ketë autonomi të serbëve në Kosovë, se nuk do të kenë model të Republikës Serbe në Republikën e Kosovës, se nuk do të ketë status special, se nuk do të ketë shkëmbim territoresh, se nuk do të ketë model të Tirolit, as të Katalonisë, apo ndonjë model tjetër, dhe se nuk do të ketë as model Ahtisari +. Por, do të jetë shteti i pavarur sovran funksional, pra Kosova e pavarur sovranë, atdhe i të gjithë qytetarëve të saj dhe shumë shpejt pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Unë jam i bindur se këto ide rrjedhin në Beograd, diskutohen në Beograd, prezantohen në mediet e Beogradit, por ju ftoj të gjithëve të koncentrohemi në respektimin e plotë dhe unik të Kushtetutës së Kosovës dhe në ligjet e Kosovës.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve për një bashkëpërgjegjësi. Natyrisht, Qeveria e Kosovës do ta kryejë përgjegjësinë e vet kushtetuese dhe ligjore, por së paku ju lus të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin, së paku ata që kanë qenë në Vjenë, ata që e kanë votuar dokumentin e Ahtisarit, të mos bëjnë keqinformime dhe keqinterpretime në opinionin publik. E vërteta është kjo që e them këtu dhe ekziston një e vërtetë: Nuk do të ketë ndarje të Kosovës, autonomi, Republikë Sërpska, status special, shkëmbime territoresh, Ahtisaari+, as Tirol, as Kataloni në Republikën e Kosovës.

Ata që kanë qenë të gatshëm të pranojnë autonomi edhe sot flasin për gjëra të tilla, e dinë shumë mirë, e di edhe unë, i dini edhe ju. Të mos flas për individë, së paku të mos flasim. Përndryshe, do të flasim edhe ne.

Po e ritheksoj, në këtë moment të konsolidimit të shtetit tonë, ju ftoj të jemi korrektë në krye të përgjegjësiave tona shtetërore. E theksoj edhe një herë, as për mua personalisht nuk janë të lezetshme ato takime, nuk kanë qenë të lezetshme as për ju që keni marrë pjesë në Vjenë, nuk kanë qenë të lehta as për të gjithë ne që kemi qenë në Rambuje, por shkuam bashkë në Rambuje dhe fituam. E nënshkruam marrëveshjen bashkë me ndërkombëtarët, ndodhën bombardimet, e fituam lirinë dhe e çliruam Kosovën.

Unë kam qenë në opozitë, jemi vënë mbi interesat partiake, për të ardhur në Vjenë. Në të gjitha takimet, me të gjitha potencialet partiake jemi vënë në shërbim të shtetit, në shërbim të statusit politik dhe fituam.

Prandaj, unë ju ftoj, pavarësisht raporteve opozitare, dëshiroj të falënderoj për mbështetjen e vazhdueshme dhe për mundësinë që ma keni dhënë për të më dëgjuar që të ju informoj, së paku ata, flas për Aleancën dhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës, ju ftoj që aty ku mund të ndihmohet, të na ndihmoni, aty ku me të vërtetë meritojmë kritikë - na kritikoni. Por, e kemi një qëllim të përbashkët - konsolidimin e shtetit tonë.

Faleminderit!

**KRYETARI:** Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare. Por, para se ta marrin fjalën kryetarët e grupeve parlamentare, jua përkujtoj se pika e rendit të ditës është: Raporti i kryeministrit për takimin e pestë me kryeministrin serb në Bruksel.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

**ARSIM BAJRAMI:** I nderuari kryetar i Kuvendit,  
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra,  
Ministra të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,  
Më lejoni që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës t'i jap mbështetje të plotë informatës dhe raportimit të kryeministrit të Kosovës lidhur me vazhdimin e procesit të normalizimit dhe të shpreh qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës se në këtë proces e konsiderojmë si një proces të rëndësishëm, si një proces shtetëror.

Dhe, u bëjmë sërish ftesë të gjitha partive politike që të kontribuojnë në këtë proces, të marrin pjesë, të jenë konstruktivë, në mënyrë që kjo agjendë shtetërore e Republikës së Kosovës të përmbillet me konsolidimin e plotë të shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë,  
Procesi i normalizimit të raporteve me Serbinë ka tri objektiva kryesore. Objektivi i parë është që të vendoset gjendja kushtetuese dhe gjendja ligjore në veri të Kosovës, të vendoset sovraniteti dhe integriteti i plotë i Republikës së Kosovës dhe të kompletohet

ndërtimi i shtetit të Kosovës dhe ne i japim plotësisht mbështetje këtij procesi, sepse vazhdimi i status quo-s është një proces, i cili e ka dëmtuar konsolidimin e plotë të shtetit.

Qëllimi i dytë i këtij procesi, pa dyshim është integrimi i veriut brenda sistemit kushtetues dhe politik të Republikës së Kosovës, integrimi nëpërmjet një procesi legjitim demokratik, nëpërmjet procesit të zgjedhjeve, integrimi në të gjitha institucionet e Kosovës dhe fillimi i realizimit të të drejtave të qytetarëve serbë në veri, të drejta që i garanton Pakoja e Ahtisarit.

Dhe, objektivi i tretë është normalizimi i raporteve me Serbinë dhe fillimi i agjendës evropiane për Republikën e Kosovës, duke e neutralizuar bllokadën dhe destruksionet që Serbia ia ka bërë Kosovës gjatë këtij procesi të normalizimit të raporteve.

Ne vlerësojmë se informimi i kryeministrit është një praktikë jashtëzakonisht e mirë institucionale, jo vetëm ky i fundit. Është hapur një proces i transparencës dhe është manifestuar edhe një kulturë politike e përfshirjes gjithinstitucionale në një proces çfarë është procesi i normalizimit të raporteve me veriun.

Ne jemi të sigurt se nëpërmjet këtij procesi në fakt do të funksionalizohet plotësisht detyrimi i shtetit të Kosovës, i marrë me Deklaratën e Pavarësisë, i marrë me Kushtetutën e Kosovës për implementimin e plotë të Pakos së Ahtisarit.

Më lejoni, të nderuar kolegë, të ripërsëris diçka që tanimë për ne deputetët është e qartë. Sistemi kushtetues, sistemi politik, sistemi i qeverisjes së Republikës së Kosovës është i kodifikuar dhe me asnjë proces nuk mund të ndryshohet. Kosova i ka bërë të gjitha kompromiset e mundshme në vigjilje të shpalljes së pavarësisë, në vigjilje të miratimit të Kushtetutës me miratimin e Pakos së Ahtisarit dhe ne tani po ballafaqohemi edhe me një pjesë të realitetit të Pakos së Ahtisarit. Po ballafaqohemi me faktin që Pakoja e Ahtisarit ka paraparë për pakicën serbe një status të avancuar me të drejta, që ndoshta e tejkalojnë edhe kornizën evropiane për të drejtat dhe minoritetet, por edhe Kornizën Evropiane për Qeverisje Lokale.

Mendoj se takimi i pestë ka qenë një takim jashtëzakonisht dinamik dhe është pritur të jetë dinamik, sepse takimet e mëparshme kanë ardhur deri te esenca e këtij problemi. Dhe, unë do të veçoj pesë çështje që janë diskutuar në këtë takim dhe që priten ndoshta në takimin e parë të ardhshëm edhe të finalizohen.

Momenti i parë është jashtëzakonisht pozitiv. Vendimi, tani i pranuar edhe nga Serbia, që të fillohet me shpërbërjen e strukturave jokushtetuese dhe joligjore në sferën e sigurisë, ndalimin e financimit nga Serbia, struktura këto që kanë qenë burim i krimit, burim i destabilizimit dhe burim i agresionit, që është bërë ndaj Kosovës.

Tanimë pas shumë hezitimeve, edhe lidershipi i Serbisë ka pranuar që këto struktura të shpërbëhen dhe ky është një sukses i madh, sepse do të mundësojë që strukturat e sigurisë së Serbisë të mos jenë pengesë.

Momenti i dytë shumë i rëndësishëm është pranimi i zgjedhjeve lokale për pjesën veriore të Serbisë dhe krijimi i legjitimitetit demokratik të udhëheqjes serbe dhe ne e përshëndetim këtë vendim dhe është në të mirën e qytetarëve serb që të kenë udhëheqës legjitimë, të kenë udhëheqës që nuk manipulojnë me ta, por udhëheqës që punojnë për të drejtat e tyre.

Shembulli i përfaqësuesve politikë serbë në pjesën tjetër të Kosovës është një shembull i mirë, që duhet të ndiqet, sepse duke marrë pjesë në proceset zgjedhore, qytetarët serbë që jetojnë në veri do të fillojnë t'i gëzojnë të drejtat dhe do të lirohen nga presionet e përditshme që bëjnë grupet kriminale, duke ushtruar torturë edhe ndaj tyre.

Dhe, pa dyshim që krijimi i strukturave legjitime nëpërmjet zgjedhjeve që parashihen të mbahen në këto katër komuna do të bëhet në bazë të legjislacionit të Kosovës dhe është e kuptueshme se në ciklin e parë do të bëhet me një monitorim ndërkombëtar të OSBE-së.

Më lejoni të ndalem te një temë shumë e përfolur dhe nganjëherë edhe manipulative, jo vetëm në media, por edhe nga disa njerëz që janë edhe të informuar. E tha shumë mirë kryeministri, një pjesë jona që jemi këtu kemi përvojë të gjatë në negociatam edhe në Rambuje, edhe në Vjenë, por pothuajse 1/3 e atyre që janë në këtë legjislaturë janë nënshkrues të Deklaratës së Pavarësisë dhe nënshkrues të Kushtetutës së Kosovës dhe i kanë votuar ligjet dhe të gjithë ne e dimë që në Deklaratën tonë të Pavarësisë është zotimi i Republikës së Kosovës që t'i zbatojë plotësisht obligimet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit.

Kryeministri e sqaroi, por dua ta ripërsëris. Nuk ka as teori, as mundësi praktike për aplikimin e asnjë statusi special, asnjë ndarje, asnjë autonomie, sepse kjo do të thoshte përmbysje e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës. Ata që e kanë një përvojë politike, kanë dalë prej adolleshencës politike e dinë se statutet speciale, ndarjet nuk mund të bëhen pa ndërrimin e Kushtetutës dhe pa ndërrimin fundamental të sistemit politik dhe të qeverisjes.

Sistemi politik i Kosovës është sistem i ri, i ka vetëm pesë vjet, por është një sistem evropian, i cili bazohet në Kosovën si shtet unik, i pandashëm, por në Kosovën me një decentralim të avancuar dhe me një qasje afirmative ndaj pakicave, gjë që do të thosha do ta krijojë një imazh të Kosovës.

Kështu që tema që po përflitet dhe që po manipulohet, çështja e asociacionit të komunave, është diçka që është përcaktuar në Ligjin për zgjedhjet lokale, Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal, në Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale në frymën dhe konceptin e Pakos së Ahtisarit dhe ne nuk duhet të manipulojmë që asociacioni do të thotë formimi i autonomisë, apo formimi i pushtetit ndërmjet, sepse kjo është e pamundur. Është e pamundur derisa ne nuk e fillojmë procesin e ndërrimit të legjislacionit për zgjedhje lokale, të cilën e kemi miratuar me 2/3-at.

Në fakt, asociacioni i komunave është një praktikë e mirë evropiane e pushtetit lokal, praktikë që ne do të sugjerim të zgjerohet dhe të aplikohet për tërë regjionin dhe do të

sugjeronim që të aplikohet edhe në territorin e Republikës së Serbisë, për të mundësuar bashkëpunimin e komunave të Luginës së Preshevës me komunat e Kosovës dhe për ta stimuluar këtë praktikë të mirë evropiane si praktikë të gjerë regjionale.

Mendoj se ky asociacion duhet të merret vetëm me çështjet që janë tipike për asociacionin, me çështjet e koordinimit të bashkëpunimit ndërkomunal, me çështjet e bashkëpunimit ndërkomunal, pa asnjë kompetencë ekzekutive legjislative dhe ekzekutive, sepse as që ka asnjë mundësi teorike që kjo të bëhet.

Së fundi, këto ditë jemi duke i përcjellë edhe disponimet e lidërshiptit serb dhe ne po e shohim një kaos në spektrin politik serb, apo një panik, duke thënë që delegacioni i Kosovës është shumë i ngurtë dhe nuk lëshon pe në asgjë, dhe duke thënë se edhe Bashkimi Evropian është në përkrahje të delegacionit të Kosovës. Dhe, ne duhet të jemi plotësisht të sigurt se Qeveria e Kosovës, por edhe Parlamenti i Kosovës, do t'i mbrojnë interesat nacionale, do ta realizojë këtë detyrë shtetërore.

Kryeministri dhe ekipi i tij janë negociatorë të sprovuar. Ata i kanë fituar të gjitha betejat politike me Serbinë. I kanë fituar edhe atëherë, kur skeptikët nuk kanë menduar. Dhe, ne jemi të sigurt që ky proces i normalizimit do të përfundojë. Do të përfundojë në të mirën e Kosovës dhe do t'ia hapë asaj një rrugë për të shpejtuar procesin e integritit evropian dhe ne kërkojmë nga Bashkimi Evropian që ta vlerësojë konstruktivitetin dhe proaktivitetin e palës kosovare dhe ta ndërtojë agjendë të njëjtë evropiane për Kosovën me Serbinë, në mënyrë që vërtet pesë shtete, të cilat deri më tani e kanë bllokuar unitetin evropian për njohjen e Kosovës, të fillojnë të lëvizin, ta njohin pavarësinë e Kosovës. Kosova të bëhet partner i barabartë i Bashkimit Evropian dhe të na hapet edhe mundësia që ta fillojmë anëtarësimin brenda Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ne e dimë që me këtë proces të normalizimit nuk përfundon konflikti shqiptaro-serb, i cili është shumë kompleks, por ne e dimë që do të ndalet destruksioni i Serbisë dhe procesi i normalizimit do ta hapë perspektivën edhe për qytetarët serbë në veri, të cilët janë peng i grupeve kriminale dhe do të fillojë procesi i integritit.

Duke e pasur parasysh që procesi po shkon drejt dinamizmit, të kujtoj vetëm edhe një fakt, së paku për...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Racionalizojeni kohën dhe mundësisht qëndroni brenda rendit të ditës. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Do të mundohet t'i përmbahem rendit të ditës, siç e thatë edhe ju shumë qartë. Por, më lejoni vetëm një koment ta bëj, meqë e kam të drejtën ta shpreh mendimin se pjesa e parë e prezantimit të kryeministrit, se aq mirë i kem punët, sa na e kanë lakmi edhe shtete dhe vende përreth, edhe qytetarë, sa që është rrezik, vërtet s'po dëshiroj të ironizoj, por është

rrezik nga invazioni i azilkërkuesve, sepse është mirë këtu të jetohet. E di edhe kryeministri që nuk i kemi kështu punët, i kemi, të mos them siç thotë populli 'pus', po edhe keq. Sidoqoftë, është e drejtë e kryeministrit të thotë kështu, sepse e udhëheq Qeverinë, edhe kur nuk është ashtu, ose kur ne të tjerët nuk pajtohemi.

Sigurisht edhe punën e Vjenës ne asnjëherë nuk e kemi mohuar, zoti kryeministër, që kemi qenë pjesë e shtetformimit dhe e shtetndërtimit dhe LDK-ja për këtë absolutisht ndihet mirë dhe këtë asnjëherë nuk e kemi kontestuar. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë që në këtë proces, i cili po zhvillohet, nuk ka rreziqe dhe ne e kemi obligim të gjithë që këto rreziqe t'i shprehim, dhe këto shqetësime që mund të dalin para nesh.

Që nga fillimi i bisedimeve, si LDK e kemi thënë qartë se nuk kemi qenë në fillim të kënaqur se si janë zhvilluar ato. Sidoqoftë, pas miratimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës u përcaktuan vijat e qarta mbi të cilat nuk mund të kalohet, i dhamë mbështetje, por vazhdojmë t'i shprehim shqetësimet tona se mos gradualisht, me zhvillimet e fundit, me paralajmërimet e fundit, këto vija mund edhe të shkelen.

Kemi qenë dhe jemi për atë që të drejtat e komuniteteve pakicë, në këtë rast të komunitetit serb, të respektohen, por të respektohen dhe të realizohen ato që janë të përcaktuara me ligjet tona, me Kushtetutën tonë, as më shumë, e as më pak se sa që ato parashohin.

Sigurisht që informacionet që vijnë dhe nga ajo që u dëgjua nga kryeministri, megjithatë, nuk mund ta heqin shqetësimin tonë që këto zhvillime, veçmas ato që kanë të bëjnë me formimin e asociacionit të komunave serbe, sipas asaj që thotë kryeministri Thaçi, dhe bashkësisë serbe, qysh kanë dëshirë t'i thonë, ose e thotë pala serbe, me drejtë shqetësohemi se formimi i këtij trupi mos eventualisht e legjitimon një formë të tretë të pushtetit të Kosovës, gjë që është totalisht, siç u tha, e papranueshme dhe besojmë që do të qëndrojnë deri në fund që edhe e tillë të mbetet.

Cilat janë këto pyetje që shtrohen me të drejtë dhe e brengosin Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës?

Ne jemi të vetëdijshëm se me ligjet tona lejohet formimi i asociacionit në këtë rast, por pse kjo të normohet tani? Pse të insistohet që kjo të jetë obligative? Këto janë të parapara dhe kjo e drejtë si organizatë vullnetare mund të ndodhë më vonë, nëse atje duhet të mbahen zgjedhjet lokale, në pjesën veriore.

Pse kjo nuk mbetet eventualisht që të ndodhë pas këtyre zgjedhjeve, përkatësisht pas zgjedhjeve në Kosovë, duke përfshirë edhe komunat në veri, pastaj të shihet mundësia dhe nevoja e formimit të një asociacioni të tillë.

Dihet se asociacionet e tilla janë organizata, po e them edhe një herë, vullnetare. Ato formohen për mbrojtjen e interesave komunale, por nuk e kanë mision mbrojtjen e interesave etnike.

Një asociacion i tillë monoetnik konsiderojmë që është në dëm të vetë komunitetit serb. Me këtë asociacion, definitivisht po i japim një goditje angazhimit, vendor dhe ndërkombëtar, që aq shumë është proklamuar në Kosovë për integrimet e komuniteteve në jetën institucionale dhe politike. Me këtë rast, mos po ndodh e kundërta?

A do të thotë se ky asociacion automatikisht nesër bëhet edhe pjesë e mekanizma të caktuara ndërkombëtarë?

LDK-ja është fuqishëm kundër çdo asociacioni apo trupi me çfarëdo emërtimi qoftë ai, që do të kishte kompetenca eventuale ligjvënëse dhe ekzekutive, edhe pse edhe një herë e ripërsëritim se nuk shohim nevojë dhe arsye që të kemi asociacion të tillë njëetnik.

Duhet definuar qartë se asgjë më shumë nuk duhet pranuar dhe lejuar se ajo që e përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet përkatëse.

Të nderuar kolegë deputetë,  
LDK-ja konsideron që shpërbërja e strukturave ilegale dhe kriminale në veri është prioritet i prioritetëve.

Kjo shpërbërje duhet të ketë edhe afat të qartë kohor. Në asnjë rrethanë ata që kanë bërë krime të natyrave të ndryshme nuk mund të bëhen pjesë e nesërme e institucioneve, për shembull komunale, dhe të tjerave, që do të dalin nga zgjedhjet në veri.

Zgjedhjet për komunat e veriut, konsiderojmë dhe mendojmë që duhet të mbahen kur të mbahen edhe zgjedhjet lokale në komunat tjera të Kosovës dhe assesi ndaras, sepse ato janë dhe duhet të mbeten pjesë integrale, territoriale, institucionale dhe konstitucionale e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,  
LDK-ja edhe një herë kërkon nga kryeministri që ta mbrojë dhe ta respektojë Kushtetutën, rregullimin kushtetues të vendit. Këtë ai e ka obligim shtetëror kombëtar, por edhe ne si Kuvend, që të mos luajmë me të tashmen dhe të ardhmen e qytetarëve tanë dhe të fëmijëve tanë.

Ta respektojë Rezolutën e Kuvendit të Kosovës. Askush nuk ka të drejtë, në këtë rast as kryeministri, pavarësisht presioneve nga kushdo dhe ngado që vijnë, ta rrezikojë integritetin dhe sovranitetin e vendit.

LDK-ja kërkon që konkluzionet, marrëveshjet apo çdo ujdë që arrihet apo është arritur të shkruhet. Kërkojmë që marrëveshjet e tilla domosdoshmërisht të sillen në Kuvend për ratifikim, përkatësisht për miratimin e tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës është dhe duhet të mbetet garantues dhe gardian i mbrojtjes së sovranitetit, i integritetit dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Asgjë që bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës sigurisht që ne nuk do ta përkrahim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

**LIBURN ALIU:** Të nderuar, deputetë,

Nga ajo që po quhet raport në këtë seancë, e deri tash asnjëherë nuk kemi marrë asgjë të shkruar, e patëm rastin që në mënyrë monotone ta dëgjojmë ripërtypjen dhe ripërsëritjen e diskutimeve të marrëveshjeve të shkruara dhe në fund, kur dolëm në pikën kryesore, po del se Hashim Thaçi në Bruksel ka shkruar të takohet me Daçiqin për t’i rikujtuar memoaret nga Vjena, pasi asgjë atje nuk qenka fol përtej Pakos së Ahtisarit. Pra, ai takimi i vështirë që paralajmërohej paska qenë gabimisht i prezantuar. Në fakt, në Bruksel, Thaçi paska shkruar të takohet me Daçiqin për përmirësim të marrëdhënieve nëpërmjet miqësisë dhe qëndrimit të përbashkët.

Ç’është ky cirk kështu? Ç’është kjo fyerje e inteligjencës për këta deputetë?

Ju folët për veriun, me mundësinë që të flitet edhe përtej veriut. Folët për atë që është në platformën e Serbisë, e që ata i thonë bashkësi e komunave serbe, dhe ju përpiqeni ta emërtoni me asociacion. E që gradualisht, takim pas takimi, po shkon drejt një autonomie të qartë për territoret e banuara me shumicë serbe.

Asociacioni i komunave me shumicë serbe e përcakton qartë territorin, vijën territoriale ndarëse ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Kur thuhet fjalët ‘me shumicë serbe’, i bie që po krijoni diçka në vija etnike, dhe kur e thoni fjalën ‘komuna’, i bie territor.

Ju po vendosni vija territoriale ndarëse në baza etnike. Kjo nuk di sesi mund të vizatohet më qartë. E kësaj nuk i thonë integrim. Kësaj i thonë ndarje e brendshme, kësaj madje i thonë thellim i ndarjes së brendshme.

Dhe, kjo nuk duhet shikuar si e vetme. Kjo duhet shikuar në raport me marrëveshjen që shkoi. Në radhën e shkruar të negociatave, këtij territori iu përcaktua ndarja e buxhetit.

Ju u morët vesh për ndarje të buxhetit të Kosovës në baza etnike në të ashtuquajturin Fond për zhvillimin e veriut. Tani ky po na del që ka mundësi të dal edhe përtej veriut.

Kjo së pari është diskriminuese, pasi privilegjimi i dikujt çdo herë bëhet në kurriz të dikujt tjetër, e kjo po bëhet mbi kurrizin e atyre më të varfërve, dhe së dyti, si po mund të quhet ky hap si integrim kjo, kur tejet e qartë se muros ndarjen. Kur një territori i ndan buxhet, atij territori i ke dhënë autonomi dhe këtu kompetencat tjera pothuaj bëhen të qarta.

Me buxhet të ndarë, që buron nga pikat 1 dhe 31, e që do të menaxhohet nga përfaqësuesi i BE-së, pra nga dikush neutral, dhe me territor të ndarë, de fakto është siguruar mosintegrimi, de fakto është siguruar autonomia.



Kur krijon asociacion në baza etnike me territor të qartë të definuar dhe, në anën tjetër, ia siguron edhe buxhetin, kjo ndryshe nuk quhet, pos autonomi. Tash, natyrisht që Serbia nuk është e kënaqur me kaq. Ajo do ende, do më tepër. Ajo kërkon më tepër, kërkon kompetenca konkrete ekzekutive dhe prandaj ekziston takimi i radhës.

Në takimin e radhës, ju do të bëni kompromise të reja. Ju do t'i definoni pikërisht qartë këto kompetenca ekzekutive në këtë territor të etnitetit që këtu përcaktohet sipas etnisë serbe dhe me financa të ndara nga buxheti. Është pa dyshim e qartë që kompromiset do të ndodhin. Do të ndodhin, e këtë e tregon më së miri dobësia juaj e treguar në takimin e fundit.

Ju zotëri keni shkuar në takim me Daçiqin pas turpfit që ndodhi në Preshevë. Ai demonstroi dhunën dhe shtypjen kundër shqiptarëve, e ju atje u takuat, thua se nuk ndodhi asgjë. Ju e legjitimuat dhunën atje.

Me legjitimimin e kësaj dhune, ju në çehren tuaj keni treguar që do të jeni të gatshëm të bëni edhe kompromise të tjera.

Ju pranuat të flisni për veriun, për serbët në Kosovë, jo më pa e vënë kusht për të drejtën e shqiptarëve në Serbi, e as pa qenë as temë çështja e shqiptarëve atje, por madje keni pranuar të flisni për veriun edhe pas poshtërimit që Daçiqi bëri me shqiptarët atje. Tani na ripërtpyni edhe marrëveshjen për diplomat. Tërë autonominë territoriale që po krijohet dhe financiare të serbëve, ju e barazoni ta balanconi me diplomat.

Zotërinj, ata njerëz atje në Serbi, ai i njëjti Daçiq po i shtyp dhe ju bëheni cinik të na flitni këtu për diplomat.

Dhe, më e rënda është se ju e quani cirk reagimin tonë.

**KRYETARI:** Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit,  
Zoti kryeministër,

Mendoj se ju e përmendët se pika e rendit të ditës është informatë për takimin e pestë në Bruksel. E vërtetë është, prej kryeministrit e morëm një përmbledhje të takimeve që kanë ndodhur edhe para takimeve të fundit dhe nuk ka asgjë të keqe pse është përmbledhje, po ishte pak e gjatë kryeministër, përmbledhja pak si e gjatë, diqysh interesante.

Sidoqoftë, Aleanca qëndron në ato që ka qenë. Jemi ofruar pastër dhe kemi insistuar, se dëshirojmë të jemi aty ku bisedohet për Kosovën, në tavolinë, kurdo që bisedohet për Kosovën, e ky është insistim edhe sot. Kryeministër, po insistojmë që kur të bisedohet për Kosovën, të jemi në tavolinë. Kemi pranuar të marrim përgjegjësi, çfarëdo qofshin ato, politike, morale, patriotike. Kemi pranuar të marrim përgjegjësi, se nuk po duam të jemi jashtë, por po duam të jemi brenda. Edhe nuk mund të vazhdojmë të marrim përgjegjësi nëse nuk jemi në tavolinë, kur bisedohet për Kosovën. Ky është mesazh që e kam thënë dje pasdite, në emër të Aleancës, po e përsëris edhe sot edhe një herë. Mendoj

se duhet të kuptohet seriozisht. Ma merr mendja se deri më tani të gjithë ata që e ndjekin politikën e dinë që ato që i themi publikisht, i themi shumë seriozisht dhe qëndrojmë prapa tyre.

Çështje tjetër me rëndësi është, duhet të përsëriten, ndoshta nuk është tepër, do të flas shkurt.

Është e vërtetë që asociacioni i komunave parashihet me ligj. Është e vërtetë që del prej Ahtisarit, por përmbajtja, u përmend këtu më përpara, nuk është e precizuar dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm me përmbajtjen, jo me emrin, se emri është në ligj, por përmbajtja nuk është në ligj.

Edhe çështja tjetër që, po ashtu u përmend, zgjedhjet. Për ne është jashtëzakonisht me rëndësi që zgjedhjet lokale në gjithë Kosovën të mbahen në të njëjtën kohë, të njëjtën ditë. Nëse duhet të kemi mekanizëm ndërkombëtar, i cili ndihmon në monitorimin e zgjedhjeve në veri për shkak të situatës, nuk bën të ndryshohet data, t'i kemi dy data dhe dy palë zgjedhje lokale në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani, e ka fjalën.

**MYZEJENE SALMANI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Dhe të nderuar qytetarë të Kosovës, të cilët sot drejtpërdrejt na përcjellin në këtë seancë.

Duke marrë parasysh rastin që ndodhi sot në Pejë, uroj që nxënësit të kenë shëndet pas atij aksidenti.

Duke marrë parasysh raportimin e kryeministrit të Kosovës, në bazë të Rezolutës, e cila është nxjerrë në Kuvendin e Kosovës që të raportojë pas çdo takimi me kryeministrin e Republikën së Serbisë dhe zonjën Eshton, e shohim të rrugës që kryeministri, edhe në bazë të Kushtetutës, është personi i cili duhet të na informojë çfarë po ndodh në ato takime.

Dhe, në bazë të asaj çfarë u tha nga kryeministri, u pa se në takimin e pestë ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe Serbisë është diskutuar çështja e shpërbërjes së strukturave ilegale në veri të Kosovës, çështje të cilën besoj që e përkrahin të gjitha subjektet politike në Kuvendin e Kosovës, për arsye se nga shpërbërja e këtyre strukturave do të arrihet që të zbatohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës në veri të Kosovës.

Njëkohësisht do të integrohet veriu i Kosovës në institucionet e Kosovës në nivelin lokal dhe në nivelin qendror dhe njëkohësisht do të arrihet që të bëhet një stabilizim i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Gjatë raportit të kryeministrit u pa se aty është arritur që të bëhet një asociacion i komunave serbe me shumicë në veri dhe në jug, ku janë komunat serbe, që të bashkëpunojë në fushat e ndryshme për interesa të ndryshme, mirëpo gjithnjë duke u bazuar në Pakon e presidentit Ahtisari dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, formimi i asociacionit të komunave serbe, edhe në veri, edhe në jug, në bazë të planit të Ahtisarit dhe ligjeve të vetëqeverisjes lokale, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, kërkojmë nga kryeministri edhe një herë, si Koalicion për Kosovë të Re, që të ketë përkrahjen më të madhe nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja, që definitivisht të bëhet integrimi i të gjitha strukturave në veriun e Kosovës në institucionale lokale dhe në institucionet qendrore. Faleminderit!

**KRYETARI:** SLS-ja nuk është lajmëruar. Grupi “6+”, jo. Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

**AGIM KULETA:** Zoti kryetar i Kuvendit,  
Zonja dhe zotërinj deputetë,  
Fillimisht, më duhet të ju them se ndihem thellësisht i zhgënjyer me faktin që paralajmërimet tona të vazhdueshme për rezultatet e këtyre bisedimeve po dalin të sakta.

Megjithatë, ky zhgënjim nuk ishte i papritur kur kemi parasysh sesi janë pritur sugjerimet tona, si Lëvizje për Bashkim, në raport me këto bisedime.

Në fakt, nuk ka si të përfundojnë ndryshe një palë bisedime në të cilat shkohet i papërgatitur, në të cilat nuk shkohet me qasjen tënde ndaj problemit si tërësi, që si i tillë nuk përfshin vetëm atë të serbëve në veri, por i përshtatesh qasjes parciais të tjetrit ndaj problemit, në të cilin nuk përfshihet ai i shqiptarëve në Kosovën Lindore.

Nuk ka si të përfundojnë ndryshe një palë bisedime në të cilat nuk shkohet për t'i shtruar qëndrimet e kërkesat tua të artikuluar në një dokument, por shkohet për të negociuar lidhur me qëndrimet dhe kërkesat e artikuluar të palës tjetër.

Dhe, në fund, nuk ka si të përfundojnë ndryshe një palë bisedime, kur në to nuk shkohet për të biseduar se çfarë mund t'u ofrojnë dy shtetet njerëzve me gjendje të njëjtë në territoret reciproke, por se çka mund të ofrojë shteti i Kosovës për serbët në veri.

Kryeministri, tërë shqetësimin e tij, ditëve të fundit, e ka pasur në sqarimin se ky asociacion është në kuadër të Pakos së Ahtisarit dhe se si subjekt nuk ndërthet në vete ingerenca ekzekutive e legislative.

Për ta ilustruar sa më thjesht këtë, ai në një rast i quajti edhe OJQ. Në qoftë se në realitet ky asociacion është vërtetë i tillë, mendoj se kryeministri ka qenë mjaft sqarues sa i përket kësaj. Por, çështja është se, edhe pse kjo e përbën një pjesë të problemit, madje një pjesë shumë të rëndësishme, megjithatë, nuk është krejt problemi. Pjesa tjetër e problemit ka të bëjë me pasojat që reflekton ky asociacion si i tillë, pra i zhveshur nga këto

ingerenca. Me këtë rast, unë dua të denoncoj publikisht një manipulim që po tentohet të bëhet këtu.

Vazhdimisht është thënë që si Pakoja e Ahtisarit, si proceset dhe zgjidhjet tjera të synuara kanë për qëllim integrimin e komunitetit serb në Kosovë. Edhe krijimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe po justifikohet nëpërmjet këtij motivi. Por, a është kjo e vërtetë?

E vërteta është që ky nuk është hap drejt integritit të serbëve. Përkundrazi, ky hap e rehabiliton distancën ndërmjet palëve. Nëpërmjet strukturave të tilla po legjitimohet krijimi i strukturave paralele, një asociacion për komunat e Kosovës dhe një tjetër për komunat me shumicë serbe. A nuk janë të Kosovës edhe këto komuna me shumicë serbe? A është integruese ta kemi një asociacion me të gjitha komunat së bashku, apo asociacione të ndara mbi baza etnike? Në këtë rast, dy gjëra janë të sigurta:

E para, ekzistimi i asociacioneve të ndara mbi baza etnike nuk janë shenjë e integritit.

Dhe e dyta, askush nga ne nuk është aq naiv sa ta besojë të kundërtën.

Për momentin, zgjidhjet e tilla edhe mund të tingëllojnë të pranueshme. Në fakt, edhe qëllimi është momental. Pra, të arrihet një marrëveshje që përkohësisht krijon perceptimin e normalizimit, por që në thelb nuk i prek problemet kryesore. Dhe, e tërë kjo bëhet për krijimin e kushteve që Serbia të ecën në rrugën e saj drejt Evropës.

Serbia edhe mund të ecën në këtë rrugë, dhe këtu nuk ka asgjë të keqe. E keqja është se ne po na mbeten problemet. Krijimi i asociacioneve të ndara ravijëzon dy kampe, dy palë, të cilat vazhdimisht do ta mbajnë gjallë frymën e konfliktit. Prandaj, këto zgjidhje nuk po i zgjidhin problemet, por po e instalojnë konfliktin institucional. Kjo vetëm do ta ushqejë mosdurimin ndërmjet palëve.

Në anën tjetër, çfarëdo aranzhmani vetëm për serbët është qasje e njëanshme e problemit, e rrjedhimisht nuk përbën zgjidhje të tij.

Këtu po mbete qëllimshëm shumë probleme në heshtje. Nuk është çështje e parëndësishme dhe e parrezikshme lënia e mijëra njerëzve pa pronë si pasojë e spastrimit etnik në veri të Mitrovicës. Nuk është çështje e parëndësishme dhe e parrezikshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë çështja e Kosovës Lindore. Ne mund të themi që atje është qetë, por jemi dëshmitarë që shumë herë, për shkak të problemeve të pazgjidhura, situata ka dalë nga kontrolli, jashtë parashikimeve të të tjerëve.

Për shkak të kësaj politike injoruese të institucioneve të Kosovës, përfaqësuesit e Kosovës Lindore detyrohen që zgjidhjen e problemeve të tyre ta kërkojnë nëpërmjet bisedimeve me Qeverinë serbe, pra me ata që ua shkaktojnë me vetëdije të plotë, e në mënyrë sistematike këto probleme, ndërkohë që për serbët e veriut bisedohet ndërmjet dy shteteve, me ndërmjetësim ndërkombëtar!

Pra, në këtë mënyrë, përderisa serbët në veri trajtohen si pjesë e kombit serb, shqiptarët në Kosovën Lindore trajtohen si pakicë! A nuk është ky standard i dyfishtë i trajtimit të njerëzve që ndodhen në të njëjtin pozicion, serbët në veri e shqiptarët në lindje? A është kjo vërtet vlerë evropiane dhe a duhet të krenohen evropianët me të? Unë nuk besoj që është kështu. Dhe, edhe po të jetë, unë do ta kem të pamundur të pajtohem me të. Ky është një veprim që e jep një mësim të keq. Kjo është një qasje që i nxit njerëzit në situata të tilla që të shkaktojnë probleme nëse dëshirojnë të trajtohen më mirë, më me respekt. Serbët e veriut sot po shpërblehen falë veprimeve të tyre kriminale, ndërsa shqiptarët e Kosovës Lindore po ndëshkohen falë sjelljes së tyre konstruktive. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

**EMIN GËRBESHI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

S'ka as pikë dyshimi se dialogu është mjet i vetëm që sjell deri te marrëveshja. Por, s'ka as pikë dyshimi se në këtë dialog apo bisedime me Serbinë ne kemi hyrë pa u përgatitur dhe pa e pasur një plan të qartë strategjik.

Në bisedime, ne ia kemi bërë një shërbim të madh Serbisë, duke ia trasuar rrugën drejt BE-së, e një obligim të tillë nuk e kemi pasur.

Bisedimet me Serbinë nuk do të duhej të bëheshin kështu siç janë bërë. Kosova është shtet dhe do të duhej të sillej si shtet, pa fusnotë e simbolika të tjera. Të paktën, është dashur t'i kushtëzojmë bisedimet me njohje reciproke e shumë çështje tjera, e sidomos me heqjen e barrikadave, me shuarjen e strukturave paralele dhe pikërisht këtu do të duhej të ishte baza e fillimit të dialogut me Serbinë.

Në asnjë mënyrë nuk është dashur të bisedohet me Serbinë për rregullimin e brendshëm administrativ të Kosovës. Çdo bisedë që do të iniciohej nga Serbia për pjesën veriore do të duhej të kushtëzohej me Preshevën, Bujanocin, e Medvegjën. Edhe krijimi i fondit, do të duhej kushtëzohej me një fond të tillë për komunat shqiptare në Serbi. Dhe, madje çdo e drejtë tjetër shtesë që do të kërkohej për pakicën serbe në Kosovë, do të duhej të kushtëzohej njësoj për shqiptarët në Luginën e Preshevës.

Këto bisedime në formë të tillë nuk janë krejt si thuhet në favor të Kosovës. Ne e kemi humbur shansin historik për t'u bërë faktor kryesor në këto bisedime, duke e detyruar Serbinë që të përulet para çdo takimi, sepse ajo ka kryer krime dhe ajo ka bërë gjenocid.

Do të dëshiroja shumë që Qeveria e Kosovës të mos e bënte një dialog të tillë me Serbinë, sepse ne jemi humbës, si në aspektin gjeopolitik, edhe në aspektin gjeoekonomik dhe vazhdimi i tillë i bisedimeve pa kushtëzimet paraprake do të sjellë pasoja për të ardhmen dhe këto pasoja do të jetë shumë e vështirë të riparohen. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,  
Ministra dhe zëvendëskryeministra,  
Deputetë të nderuar,

Unë do të mund të vazhdoja mu aty ku e kam lënë herën tjetër, kur kemi biseduar për një takim të radhës, më duket ai ishte i katërti, nëse ky ka qenë i fundit, ose i pesti. Unë dua t'i lexoj dy nene të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, që është votuar kryesisht me shumicën, më 18 tetor 2012. Neni tre thotë: "Dialogu dhe rezultatet e tij duhen të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, me subjektivitetin ndërkombëtar, me integritetin territorial dhe me rregullimin e brendshëm të rendit unik kushtetues të Kosovës".

Dhe, neni pesë: "Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar që të raportojë rregullisht në Kuvendin e Kosovës për procesin e normalizimit të relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë".

I lexova këto të dyja për shkak se nuk kemi nevojë t'i falënderohemi asnjë kryeministri të Qeverisë që negocion, se e ka detyrë shtetërore, ligjore dhe këtë raportim e ka detyrim, nuk është punë t'i bëjë qejf dikujt, ose t'ia prishë qejfin dikujt, ose të lajë borxh.

Këto janë detyrime shtetërore të Qeverisë, në këtë rast konkretisht të kryeministrit dhe të këtij Kuvendi, sepse është dokumenti që e lidh këtë proces.

Duke i pasur parasysh këto, unë sot e dëgjova kryeministrin dhe mund të them që ai ose ata që ia shkruajnë fjalimin, që këtu e lexon, janë mjeshtër, sepse shumicën e kohës ai ka folur për çështjet që i kemi dëgjuar të shumëzuara në raportimet në nivele të ndryshme, por edhe në Kuvend. Po, ai i ka prekur dy çështje, që njeriu që nuk dëgjon kujdesshëm, edhe nuk i vëren shpejt.

E ka pranuar që kësaj radhe po flet për takimin e pestë krejt në fund dhe ka thënë 'do të flas edhe paraprakisht për takimin që do të mbahet'. E falënderoj. Sepse kjo i bie që ky këto dy pika të Rezolutës së Kuvendit i ka kuptuar përnjëmend, sepse raportimi në Kuvend nuk do të thotë veç për të treguar sa herë e ka takuar Daçiqin, ose nuk e di kë të Serbisë, por raporti është për sukseset, për problemet, për abstenimet, që janë normale, për mosshkuarjen eventuale, për tërheqjen eventuale. Të gjitha këto janë stadiume të raporteve të dialogut, që mund të bëhet për një problem të madh me një shtet me të cilin kemi probleme të mëdha, edhe historike, edhe aktuale.

Prandaj, unë po them, i shoh këto dy pika pikante, domethënë atë që tregon përafërsisht për një çështje, duke e nënvizuar çështjen që në takimin e pestë ka qenë temë themelore - shpërbërja e strukturave paralele dhe në të pritshmin. Unë sa e kuptova shpejt, do të kërkohej afate konkrete të shpërbërjes. Do të krijohet mekanizmi zbatues i marrëveshjes dhe do të kërkohej një normalizim politik në veri, që i bie anticipim i asaj që do të flitet më 4 mars. Nëse është kështu, unë e falënderoj këtë anticipim para Kuvendit. Por tash, ne vijmë te puna e dëshmisë, ose e raportit të kryeministrit. Ky tha që për shpërbërjen e strukturave paralele e kemi pajtimin verbal të palës serbe.

Tash kjo verbal, 'verbum' fjalë i bie në shqip, domethënë premtime me fjalë. Po i bie që është me të folur, besoj premtimi i folur, e jo i shkruar. E unë po them menjëherë, jo premtim të folur me Daçiqin assesi, por të shkruar. Pse? Ideologu nacional i shekullit XX i Daçiqit dhe i krejt Serbisë, Qosiqi, thotë duke u lavdëruar: "Ne jemi popull që rrejmë më së bukuri, më së miri në dynja". Po, po kjo është vepër, unë nuk po shpif asgjë.

Me një fjalë, nëse ideologu i tij thotë që ne flasim dhe rrejmë bukur, atëherë nuk kemi arsye as ne t'i besojmë, aq më tepër që nuk do të ndodhë ashtu në një propozim me fjalë. Pra, duam tekste, tekste të marrëveshjeve, në mënyrë që të mos ketë ekuivoke.

Tjetër? Është çështja ç'janë këto struktura që do të shpërbëhen? Kryeministri e ka nënvizuar shpeshherë 'strukturat e sigurisë ilegale'. Në veri, siç po quhen ato komuna, ku nuk qeveris deri më sot Kosova dhe ligjet e Kosovës, ka struktura që nuk janë veç struktura sigurie. Dhe, ky është diskutimi im që lidhet me atë të parahershmin, që e ndërpreva atëherë.

Ka struktura të arsimit, ka të shëndetësisë, të gjitha strukturat e një jete kolektive të një ambienti. Kështu që unë mendoj që të mos kalohet me thjeshtëzim me litotë, 'jo të sigurisë janë më të rrezikshmet, do t'i shpërbëjmë, e tjerat do t'i adaptojmë'. Nuk ka adaptime të kurrfarë strukturash. Duhet të hiqen strukturat paralele, të mos normalizohen, se çdo strukturë paralele kur e pranon, ajo bëhet normale.

Unë e dëgjova kryeministrin që tha në një moment, edhe sinqeriteti sigurisht, me telashe në formulimin: "Unë jam i gatshëm të marr vendime të vështira". Pse t'i merrni vendimet e vështira?

Zotëri kryeministër,

E di që detyroheni, ose ju detyrojnë, ose rrethanat të detyrojnë për të marrë vendime të vështira. Unë them, ndaleni hapin, kthehuni, këshillohuni, mos u ngutni. Krejt këto janë taktika të dialogut. Nuk është e thënë të merret turr domosdoshmërisht filan ditë për t'u marrë vesh për diçka. Jepini kohë vetes, jepini kohë këtij Kuvendi që ka detyrime kushtetuese e ligjore të marrë bashkëfajësi ose bashkëmeritë të vendimeve për këtë vend, jepini kohë edhe Kuvendit le ta testojë, ose ta sjellë në referendum, nëse është i detyruar të japë mendime për situata të mëdha, të cilat nuk ia bartin shpatullat politike. Të gjitha këto janë rrahë pushtetesh e obligimesh që ju juve japin më shumë shanse, më shumë mundësi sesa nëse ju shkoni si një vetmitar, që e luani heroin dhe thoni 'unë marrë vendime të vështira'. Jo, nuk ju duhen gjë as juve, as neve, askujt vendimet e vështira, nëse nuk janë domosdoshmëri historike, sepse zotëri kryeministër, po të drejtohem këtu, se tash qenke këtu. Nuk ka nevojë ta luajmë politikanin asnjëri prej nesh. Ti e the në fjalim, edhe pajtohem me ato pjesët, jo poenë zgjedhorë e jozgjedhorë. Nuk i vyejnë askujt asgjë, sepse këto janë vendime historike për këtë vend, që do të merren ose nuk do të merren, dhe nuk kanë të bëjnë me një brez, dhe nuk kanë të bëjnë me ju si Qeveri, dhe me këtë situatë dhe me këtë Kuvend, me këtë legjislaturë. Këto janë detyrime që i kapin gjeneratat dhe unë kur dal këtu, edhe sot edhe herët tjera, qoftë u kuptova qoftë, nuk u kuptova, unë flas nga kjo perspektivë, jo nga ndonjë perspektivë tjetër.

Nëse më lejon zoti kryetar i Parlamentit, veç edhe një fjalë ta them. Është bërë një farë, sikur tekst i Biblës a Kuran, a s'di çfarë të them, ky farë programi i Ahtisarit. Ata që e kanë bërë atëherë, kur e bënë në këto salla, thoshin ky është sendi më i mirë që e ka arritur Kosova. Ne i kemi mbajtur dy mbledhje plenare dhe kemi biseduar për to. Shkoni merrini lexoni kush çfarë ka thënë. I keni. Tash varet prej pozitave, ai që nuk është në pozitë thotë ka qenë i keq, ai që është në pozitë thotë ka qenë i mirë. E këto janë krejt 5 vjet. Nuk jemi moti. Të mos skuqemi prej atyre që i thonë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Regjia, vazhdoja edhe pak!

**SABRI HAMITI:** Unë po flas për Kuvendin, hiç të mos xhirohet, se nuk më intereson. E ju po më dëgjoni.

Edhe planin e Ahtisarit, kur e ka votuar Parlamenti i Kosovës, i ka katër pika rezoluta, thotë: Këto janë lëshimet e dhimbshme, ka thënë i gjithë Grupi i Unitetit, por edhe deputetët. Por, po i bëjmë, sepse është e vetmja mënyrë si na pranon Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, zotërinj, sepse miqtë tanë, alias këta, këta, këta, i kanë garantuar Grupit të Unitetit që ky formulim na fut në Kombet e Bashkuara dhe kalon në Këshillin e Sigurimit dhe ashtu me ato kushte, merrini lexoni edhe ato, nuk ka qenë symbyllur Parlamenti as para 5 vjetësh, e ka ditur çfarë po ndodh.

Pra, nuk na ka pranuar Këshilli i Sigurimit dhe kemi dalë lypës prej një në një, sepse është kaluar në fazën tjetër. Prandaj, kur e përmend planin e Ahtisarit, është një fazë, nuk është diçka që ka garantuar çfarë ka thënë, por ka qenë një element që është përdorur politikisht, edhe prej Kosovës për ta shpallur pavarësinë, por do ta përdorin politikisht edhe të tjerët. Pra, lexojeni, dialogu është për t'i mbrojtur pozitat dhe për t'i fituar. Askush nuk të jep asgjë 'bianco', as plani i Ahtisarit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të lidhem në fillim me atë që e përfundoi profesor Hamiti me planin e Ahtisarit dhe të ndërlihem edhe me atë që themi jemi të përgatitur apo jo në këto bisedime.

E pranojmë faktin botërisht besoj të gjithë ne që nuk jemi gardianë të planit të Ahtisarit, por besoj të gjithë po ashtu e pranojmë që ajo është plafoni, nëse më lejohet ta them, apo limiti i optimumit dhe i maksimumit tonë. Dhe ky plan sot besoj që na ndihmon të gjithëve në kuptimin e asaj që themi kompromisi ka ndodhur më herët dhe sot për herë të parë ne shkojmë në dialog, natyrisht pas rrethanave të krijuara, ju me ndonjë aplaudim të



veçantë, në momentin kur e kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kur i kemi ligjet e Republikës së Kosovës dhe e kemi shtetin e Kosovës me institucionet e konsoliduara, kur vendimmarrja nuk është në një individ, por është në një institucion, që quhet Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Më lejoni t'i theksoj që në fillim disa çështje teknike organizative dhe t'i eksploroj një nga një.

E para, delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka pasur dokument të shkruar që ia ka dërguar baroneshës Eshton për çështje që kanë të bëjnë me drejtësinë, me sigurinë dhe me çështjet e asociacionit të komunave të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, më lejoni të theksoj se brenda këtij dokumenti ka pasur të dhëna të mjaftueshme dhe të gjitha të dhënat dhe dokumenti e ka limitin në ligjet e Kosovës, e ka limitin në Kushtetutën e Kosovës dhe nuk ka diçka jashtë tyre, dhe nuk ka asgjë që duhet apo kemi dashur që ta fshehim.

Shkurtimisht po e them, sa i përket drejtësisë i kemi vënë disa kriterë:

Kriteri i parë është që Kosova ta ketë një sistem unik të drejtësisë;

Kriteri i dytë është që në Kosovë të jenë ligjet e aplikueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës;

Kriteri i tretë është që gjyqtarët dhe prokurorët, kudo që zgjidhen ata, do të zgjidhen sipas ligjeve tona dhe nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Prokurorial dhe me emërimin nga Presidentja e Republikës, dhe po ashtu jemi pajtuar që Gjykata Themelore e Mitrovicës t'i ketë degët e veta në Skenderaj, në Vushtrri, por edhe në Leposaviq dhe në Zubin-Potok dhe në të gjitha këto të reflektojë edhe përbërjen etnike, por gjithmonë me autoritetin e vijës të drejtësisë në Gjykatën Themelore, në Gjykatën Supreme dhe me atë të Apelit në Prishtinë.

Po ashtu, më lejoni të theksoj sa i përket asociacionit të komunave, që është bërë një zhurmë pak më e madhe, unë e di që asociacioni i komunave aludon gjithmonë në një autonomi, aludon në një të drejtë politike që dikush mund ta thërrasë dhe po ashtu e di që frika më e madhe është në këtë balancim. Por, po ashtu, do ta pranojmë një fakt, që edhe Serbia mund të jetë dhe është më e tolerueshme sa i përket drejtësisë dhe sigurisë nëse do ta kishte si kundërvlerë një veprim politik. Pse e mendojmë këtë? Jo për veprimin që mund ta bëjnë sot, por për veprimin që mund të japë të drejtë pas 10 vjetëve, pas 20, apo një periudhe tjetër, kur gjendja në terren mund të ndryshojë, ose në të mirën tonë, apo ndoshta edhe në të mirën e dikujt tjetër.

Por, ajo çfarë dua të them - në ofertën tonë në asociacionin e komunave e kemi pasur Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 30, 31 dhe 32.

Në nenin 30, pika 1, 2 dhe 3, parashihet qartë si kanë të drejtë komunat të kenë bashkëpunim ndërkuftar.

Në nenin 31 parashihet qartë si kanë të drejtë të themelojnë asociacion.

Dhe në nenin 32, cilat janë kompetencat e tyre.

Kërkesat që mund të vijnë nga Serbia, e kjo është bërë zhurmë më shumë, për mënyrën e zgjedhjes së njerëzve në këto asociacione dhe për fuqinë ekzekutive, kanë qenë dhe janë të refuzuara nga ne.

Ne jemi pajtuar që kryetarët e komunave, që zgjidhen sipas zgjedhjeve të lira dhe demokratike, të organizuara nga ne, të certifikuara nga Komisioni Qendrorë Zgjedhor, me një asistencë nga OSBE-ja, ata mund të jenë pjesëtarë të këtij asociacioni, por jo dikush tjetër. Ndërsa fuqi ekzekutive as s'i ka shkuar kujt ndërmend që t'i japë një asociacioni të tillë, se ajo do të nënkuptonte një pushtet të ndërmjetëm, do të nënkuptonte ligj të ri për vetëqeverisjen lokale, kushtetutë të re dhe sistem të ri politik, siç e tha edhe profesor Bajrami.

Më lejoni të theksoj sesa u përket strukturave të sigurisë, unë po ju them që dokumenti i dërguar nga ne, me një falënderim të veçantë për organet kompetente të sigurisë së Kosovës, me një bashkëpunim me ato ndërkombëtare, janë identifikuar edhe individët që punojnë në strukturat e sigurisë së Serbisë, qoftë të MUP-it, BIA-s, apo dikujt tjetër, dhe besoj ky dokumentim ka qenë i mjaftueshëm që Serbia të bindet që ata duhet të hiqen nga territori i Republikës.

Seleksionimi dhe regrutimi i ri do të jetë sipas ligjeve tona dhe gjithmonë duke marrë parasysh për ata që nuk kanë të kaluar kriminale.

Më lejoni t'i them edhe 2-3 çështje, që ndoshta janë me rëndësi, sa i përket asaj që po përmendet këtu dhe hapte dilema.

E para, në takimin ku ka qenë edhe zoti Shala, edhe unë, natyrisht kryeministri i republikës së Kosovës ia ka vënë zonjës Eshton dy kërkesa.

E para, që të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani, konkluzionet, çkad që mund të jenë, të përfundojnë me një marrëveshje të shkruar, të nënshkruar nga kryeministri i Republikës së Kosovës, nga kryeministri i Serbisë dhe nga zonja Eshton, si dëshmitare e kësaj marrëveshjeje dhe ajo marrëveshje të vijë e të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por edhe në Kuvendin e Republikës së Serbisë.

Dhe e dyta, ka qenë një kërkesë që ta kemi një Komision Mbikëqyrës, në të cilin të jenë kryeministrat e dy vendeve respektive dhe zonja Eshton. Në takimet e përmuajshme të vërtetojnë sesi po kryhet marrëveshja, realizimi dhe interpretimi i saj.

Dhe, dy çështje tjera krejt teknike, që besoj janë pjesë gjithsesi e këtyre marrëveshjeve: do të jetë organi implementues dhe do të jenë afatet e implementimit.

Ne kërkojmë gjithmonë që roli i implementimit të marrëveshjeve në veri të jetë nga mekanizmat ndërkombëtarë, nga mekanizmat vendorë, por edhe nga përfaqësimi i serbëve lokalë që jetojnë në atë pjesë. Dhe, po ashtu, koha e implementimit duhet të jetë me afate kohore.

Çdo mospërcaktim i afateve të implementimit të organeve që implementojnë, pastaj marrëveshja do të degradohet dhe në momente të caktuara do të mbetet si diçka vetëm në letër.

Ndoshta edhe 2-3 çështje që po përmenden edhe lidhur me kushtet, edhe me çështjet që kanë të bëjnë me raportet me BE-në.

Dua të them që Kosova është me fat që është në anën e BE-së, në anën e SHBA-së, por edhe ata janë në anën tonë. Por, ato janë në anën tonë për aq sa ne jemi në kuadër të limiteve që ne i kemi arritur bashkërisht me ata.

Por, besoj, në anën tjetër, sa u përket kushteve, unë e kam përmendur shpeshherë, janë dy strategji.

Strategjia e parë është të arrihen çështjet, të vendosen kushtet, pastaj të bëhet dialogu.

Dhe e dyta, të bëhet dialogu për t'i arritur ato që mendojmë se janë kushte. E e përmendi zoti Gërbeshi njohjen. Unë do të isha shumë i lumtur që të fillojmë çdo bisedë me një shtet tjetër me njohje paraprake.

Por, duhet ta pranojmë një fakt: veriu i Kosovës ka mbetur pa sovranitetin tonë për tri arsye. Paksa shumë e sigurtë mund t'i duket dhe jo shumë politike.

E para, kapacitetet e limituara të Kosovës;

E dyta, gatishmëria jo e mjaftueshme e ndërkombëtarëve në Kosovë, por edhe diku tjetër, për ta shtrirë autoritetin në atë pjesë;

Dhe e treta, ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Serbisë.

E, tani çfarë po bëjmë? Ne po angazhohemi më shumë, po e kërkojmë mbështetjen ndërkombëtare, të rritet gatishmëria e tyre dhe po kërkojmë që Serbia të mos ndërhyjë në punët e brendshme që ta shtrijmë autoritetin në tërë territorin e Republikës sonë.

Dhe, krejt në fund, unë e di gjithmonë që negociatat apo dialogu mund të jetë i suksesshëm, negociatorët më pak. Por, gjithmonë njerëzve që dialogojnë duhet t'ua japim një limit. Limiti po e quaj prej 5 deri 10, ose prej 8 deri 10, por nuk mund të jemi..., limiti te ne duhet të jetë pika reference - Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ligjet e

miratuara në Kuvendin e Kosovës, bisedat tjera, dialogimet tjera, emocionet tona unë i kuptoj. Janë emocione pozitive, nganjëherë ndikojnë edhe në korrektimin e gjithë neve që marrin pjesë në këtë proces. Por, në anën tjetër, duhet të kemi besim te njëri-tjetri dhe po ashtu, edhe për ata që kanë dilema, edhe po të dojë një njeri në këtë vend, në kohën e demokracisë nuk mund ta ndryshojë vendin. Në kohën e demokracisë vendi ndryshohet nga përfaqësuesit e popullit. Bile në rastin konkret, kur kemi të bëjmë me marrëveshje për paqe, për luftë, për territor, për financa, kërkohen 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kështu që marrëveshjet duhet të jenë brenda Kushtetutës dhe cilado marrëveshje duhet të jetë e ratifikuar në Kuvendin e Republikës, dhe natyrisht Kuvendi është korrektues ynë, por Kushtetuta është korrektues i të gjithë neve që jemi këtu. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, nënkryetari Sabri Hamiti.

**SABRI HAMITI:** Zoti Kuçi ma dha shansin, se ma përmendi emrin, dhe unë vazhdoj edhe dy sende t'i theksoj.

Pse është me rëndësi secilën herë të flitet hapur në Kuvend, e sidomos kësaj radhe, para se të shkohet atje. Kjo është më e dobishme, sesa të flitet pas. Për shkak se zgjidhjet, zgjidhja e tërësishme po mendohet një farë mozaiku, që do ta nënshkruajnë tre veta. Po kjo ndërtohet me copa. Në atë mozaik si tërësi mund të futet një copë kaq e keqe, që mund ta prishë krejt pikturën. Prandaj, është mirë që të verifikohet çdo zgjidhje me kohë dhe të saktësohet.

Edhe e dyta, është garancia ndërkombëtare. U thashë, pa e shkruar jo se jo, dhe pa garanci ndërkombëtare jo se jo, se nuk do të zbatohen. Pa garanci të fortë, dhe tutje, pa garancitë e atyre që nuk kanë qëndrim neutral ndaj statusit; se asnjë organizatë, qoftë e BE-së, e kujtdo qoftë, e cila vjen këtu dhe thotë po implementoj diçka, por kam qëndrim neutral ndaj statusit, nuk do të implementojë asgjë të vlefshme me kohë, por do ta shtyjë në kohë deri në paskajësi.

Edhe problemi i formulimeve, unë i dëgjova kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin, nuk do të ketë kësi, kësi, krejt ato janë klishe. Shikoni, mund të përshkruhen funksionet, por kur përshkruhen është me rëndësi të ruheni çka mos të jepet. Jo të thuhet s'do të jetë ekzekutiv e legjislativ, e atje i përshkruhen detyrat sikur kur gatohen prej fillimit deri në fund, por nuk thotë ka gatuar. Edhe këtu mund të ndodhë ajo. Prandaj, mund të mos i thuhet asnjë emër që ekziston kudo, por në fund duket një farë entiteti politik e territorial pa emër, por me funksion...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Kundër-replikë, zëvendëskryeministri.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit!

Besoj që profesor Hamiti vetëm mbeti borxh që nuk ia dhashë mundësinë t'i shpreh unë dy ide të tij, por unë do të them për këtë të fundit që e tha.

Unë besoj se të gjithë ne e dimë që përshkrimi i kompetencave e bën dikë me kompetencë ekzekutive ose legjislative, e nuk e bën emri. Unë e di që njerëzit që nuk janë juristë shpeshherë më shumë lidhen në emër, sesa në kompetenca. Unë e di që të dyja kanë rëndësi, por më shumë ka përshkrimi i kompetencave sesa emri, dhe unë besoj që këtu do të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm që kompetencat të jenë të nivelit të asaj që i ka edhe niveli i pushtetit në nivel lokal. Faleminderit!

**KRYETARI:** Merre fjalën, por ta kam dhënë fjalën pa rend. Arben Gashi e ka fjalën.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Megjithëse mendoj se nuk është edhe shumë pa rend, sepse sipas forcës politike, PDK-së e LDK-së u bie të flasim nga dy herë, ndërkaq partive tjera nga një herë, nëse e matin forcën relative, e para.

Edhe e dyta, unë po e marr shkas nga fjalimi i zotit Hamiti, jo për t'i dhënë mundësi për të replikuar, por nga intenca dhe kërkesa e tij që ne të flasim hapur dhe unë kam për qëllim që të flas hapur para këtij Kuvendi dhe para qytetarëve të Kosovës.

Hapur për disa gjëra, sepse kryeministri foli fshehtë. Foli fshehtë dhe foli 45 minuta për gjëra që ne i dimë dhe që janë thënë këtu, dhe foli 2 minuta për takimin e pestë, për të cilin ne jemi thirrur sonte urgjentisht, në orën 19:30. Nuk u fol këtu që Blerim Shala nuk paska marrë pjesë nëpër takime dhe se nuk e paskan pranua. Nuk e di pse. Por, kjo nuk ka rëndësi.

Për çka unë dola këtu, është ajo se mendoj se ne nuk duhet të lejojmë që të futet niveli i mesëm i qeverisjes në Kosovë. Dhe, unë dola të them këtu, me përgjegjësi të plotë, si i votuar nga qytetarët e Kosovës dhe si deputet i këtij Kuvendi, t'i japë paralajmërimet dhe vlerësimin tim për tendencat dhe drejtimet kah po shkon vendi. Ne e dimë se sipas Pakos së presidentit Ahtisari kemi qasje asimetrike për komunitetin serb në Kosovë, duke filluar nga ky Kuvend. Kemi vende të rezervuara dhe të garantuara për ta. Ndërsa zëvendëskryeministri dhe ministrat nga komuniteti serb nuk janë këtu. Duke vazhduar për komunat, kemi bërë komuna me 5 000 e 6 000 banorë vetëm për serbët, për t'i akomoduar ata brenda sistemit të Kosovës. Edhe këtë e kemi pranuar. U kemi dhënë kompetenca asimetrike në arsim dhe në shëndetësi, duke përfshirë shëndetësinë sekondare dhe arsimin universitar dhe tash po të paralajmëroj, kryeministër, se me bisedat që janë zhvilluar dhe me shndërrimin e kufirit të veriut të Kosovës në një kufi fluid është prekur edhe integriteti territorial.

Po të paralajmëroj dhe po të njoftoj kryeministër, se përveç shndërrimit në kufi fluid, me themelimin e fondit për veriun e Kosovës është prekur dhe është dëmtuar sistemi. Po të them dhe po të paralajmëroj se me tendenca që të diskutohet për kompetenca në nivelin mbikomunal, ju i quan asociacion të komunës, Serbia i quan 'zajednica', unë nuk po jap një emër, por do ta jap një konkluzion në fund. Është një tendencë që të kalohen

kompetencat në fushën e sigurisë, ku përfshihen Policia dhe struktura tjera të sigurisë në nivelin mbikomunal.

Emërimi dhe shkarkimi i komandantëve dhe i policëve është kërkesë e Serbisë, është në tavolinën tuaj. Ju e dini që e keni diskutuar.

Me diskutimet në fushën e drejtësisë, që e përmendi këtu edhe zëvendëskryeministri, është kërkuar dhe kërkohet që në nivelin mbikomunal të ketë kompetenca, mundësi dhe autoritete që të diskutohet për emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe po ashtu të ketë asimetri sa u përket prokurorëve.

Deri më tani, siç po duket nuk po lidhen fijet, mirëpo unë po ju paralajmëroj se fijet po lidhen me marrëveshjen për organizimin e zgjedhjeve, të cila pritet të mbahen. Ekziston një tendencë. Cila është tendenca? Me këtë marrëveshje të arrihet që të organizohen zgjedhje në veriun e Kosovës nga një organizatë ndërkombëtare neutrale ndaj statusit të Kosovës, por kredibile për organizimin e zgjedhjeve, e kjo do të jetë OSBE-ja.

Dhe, pastaj të kalohet në fazën tjetër dhe në këtë fazë fillon problemi me organizimin mbikomunal dhe me marrjen e këtyre kompetencave. Në qoftë se ka kompetenca në arsim, duke përfshirë arsimin universitar, kompetencat në shëndetësi duke përfshirë shëndetësinë sekondare. Kompetenca në çështje financiare duke përfshirë Fondin për veriun, kompetenca në të hyrat doganore, kompetenca në sistemin e drejtësisë duke përfshirë prokuroritë dhe gjykatat, emërimet dhe shkarkimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve, kompetenca në fushën e sundimit të ligjit duke përfshirë emërimin dhe shkarkimin e komandantëve, kjo është shume e thjeshtë. Unë po ju paralajmëroj që ju mos ta lejoni këtë, unë dua të besoj se ju nuk do të lejoni kjo të ndodhë, por kjo është shumë e thjeshtë për t'i vendosur emër pastaj, sepse emrin ia vendos formula.

Studiuesit që merren me studimet dhe vetëqeverisjes lokale, ata ia vënë emrin se është autonomi a është rajonalizim me bazë etnike, a është konfederatë, a është federatë, a është kantonizim, a është sistem lëndësh a çfarë sistemi është, nuk ka rëndësi e rëndësishme është që këto kompetenca po tentohet të lidhen fijet dhe fijet po shkojnë drejt lidhjes. Prandaj, unë po ju paralajmëroj dhe po ju kërkoj si deputet i Kuvendit të Kosovës, të mos lejoni të lidhen këto fije në fushën e arsimit, në fushën e shëndetësisë, në fushën e sigurisë, policisë, prokurorisë, gjykatave, të Fondit për veriun, kontrollit të kufirit, të mos lidhen në nivel mbi komunal. Në momentin që lidhen në nivel mbi komunal, emrin vendosjani vetë, sepse po dihet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, kryetar i Grupit “Vetëvendosje”.

**VISAR YMERI:** Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju të gjithë dje e keni parë aksionin tonë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili kanë i përbërë nga dy komponentë, komponenti i parë ka qenë vizuale ndërsa komponenti i dytë ka qenë audio, pra ka qenë komponenti i zërit dhe këto e kanë pasur një qëllim të

vetëm. Komponenti i parë vizualja, pra harta, ka pasur për qëllim të tregojë se çfarë po i bën Kosovës Hashim Thaçi pe Ivica Daçiqin, në Bruksel, ndërkohë që komponenti i dytë, pra ajo e zërit, ka pasur për qëllim të tregojë se kush është ky person, pra Hashim Thaçi, që po ia bën këtë Kosovës, ky 'pronto' kryeministër, i cili rehaton dajë. Ky imazh ka qenë më se i nevojshëm për shkak se e qartëson situatën përtej frazave boshe që po i dëgjojmë këtu në këtë Kuvend nga kryeministri, për shkak se këto nuk janë raport, këto madje nuk qenë as informatë. Ky është një magnetofon i prishur, i ngjashëm me atë që e lëshuam ne dje që e përsëriste fjalën e njëjtë vazhdimisht.

Ne e kemi dëgjuar deri tash vetëm një informatë të kryeministrit, katër të tjerat kanë qenë përsëritje të saj, herë më të zgjeruara, herë më të ngushtuara, po përsëritje të saj kanë qenë, asgjë më shumë. Raporti është krejt ndryshe edhe raporti pajtohem këtu edhe me nënkryetarin Hamiti, por edhe me të tjerët që e thanë, nuk është çështje e dëshirës apo vullnetit të kryeministrit t'i raportojë Kuvendit, është obligim, jo vetëm që rrjedh nga Rezoluta që është miratuar në këtë Kuvend, por madje, madje është obligim nga secili dokument edhe nga logjika republikane e demokracisë parlamentare funksionimit të shtetit. Ekzekutivi është përgjegjës ndaj legjislativit dhe i raporton atij për secilën çështje, pra nuk është se këtu, ky kryeministër na u paska bërë shumë i mirë dhe tash po vjen po na bën neve. Ky e ka obligim këtë, por madje s' po e përmbush këtë obligim fare.

Se raporti do të kishte qenë ndryshe, foli edhe zoti Hamiti. Raporti nënkupton të sjellë dokumente, këtu. U tha që jemi marrë vesh për këtë, jemi marr vesh për atë, por Kuvendi nuk po sheh kurrfarë dokumenti, Kuvendi madje nuk po sheh as kurrfarë transkripti të mbledhjeve. Kryeministri e përmendi, e kam përmendur disa herë tha çështjen e të zhdukurve, po çka ke thënë, kujt ia ke thënë, qysh ia ke thënë, çka të ka thënë ai, po tregona edhe këtë se e kam përmendur, por pe di po e përmend edhe këtu, mbase e ke përmendur edhe në Aeroport në Bruksel, mbase edhe me Katrin Eshtonin duke ngrënë darkë, mirëpo çka është marrë vesh për këtë punë, nëse jeni marrë vesh. Ku është dokumenti, pastaj ku është dokumenti për Fondin, se po thua e kam pranuar Fondin për Veriun, ku është dokumenti për atë fond se ky është në shpërpruthje me ligjet e Kosovës, të gjithë e dimë këtë? Pra si do të ndodhë me këtë dokument; kur do të miratohet ai, a do të sillen në Kuvend?

Çështje tjera, unë i përmend këtu, meqenëse i përmendi kryeministri, po dua vetëm edhe unë ta bëjë një kujtesë për marrëveshjet e mëhershme, pra të asaj që quhej dialog teknik më herët, se u përmenden këtu nga kryeministri si suksese shumë të mëdha të Kosovës në këtë. Pra tha që nga Marrëveshja për Kadastrën dhe regjistrin civil, Kosova paska fituar shumë, po Kosova i ka fituar kopjet e kadastrës edhe regjistrin civil të cilat ia ka vjedhur Serbia. Kjo s' është fitore, kjo është humbje për shkak ase ia ke pranuar Serbisë ta mbajë atë pronë të Kosovës shumë të rëndësishme si dokument, origjinalin, ndërkohë që ne të mjaftohemi me disa kopje të cilat verifikohen në EULEX e pastaj verifikohen prej një institucioni që po formohet në Kosovë e kështu me radhë, por ndërkohë Serbia do ta ketë origjinalet e tyre, pra, Serbia do ta ketë njëfarë mënyre fjalën përfundimtare për vërtetësinë e secilit dokument që është kopje e atij origjinali, këtë ia keni pranuar ju Serbisë, kadastrin, regjistrin civil këto janë elemente të sovranitetit të shtetit, pra keni hequr dorë nga sovraniteti i shtetit në këto dy pika.

Pastaj, u përmendën edhe marrëveshjet tjera, lëvizja e lirë për shembull, po mirë pse nuk po i përmend edhe qytetarët e Kosovës të arrestuar gjatë kalimit nëpër territorin e Serbisë, disa prej tyre ende janë duke u mbajtur nëpër burgje, përmende edhe këtë. A është ky synim i kësaj marrëveshjeje, a është kjo e mira që i është sjell Kosovës, që Serbia tash ta ketë mundësinë t'i arrestojë qytetarët e Kosovës, pra kjo paska qenë suksesi. Pastaj u përmend edhe për mallrat, lëvizja e lirë e mallrave, mendoj se kjo nuk do koment vërtet. Për çdo vit Kosovës i rritet deficitin tregtar, asnjë mall nuk është lëshuar më shumë që po shkon tash në Serbi tash për t'u shitur edhe ka pasur edhe probleme shumë të mëdha të prodhuesit e Kosovës, madje edhe për ta transportuar mallin transit nëpër territorin e Serbisë, e ju e konsideroni këtë si sukses. Sukses për ke nuk e di e as çfarë suksesi.

Po mendoj se duhet të përmendet marrëveshja mbi marrëveshje, për shkak se kjo e reflekton njëfarë mënyre edhe fjalët e Hashim Thaçit sot dhe veprimin e tij nesër. A ju kujtohet deputetë të nderuar që i njëjti kryeministër diku 3 ose 4 ditë para Marrëveshjen për fusnotën, patë thënë që edhe nëse krejt opozita pranon të heqë dorë prej Republikës, unë nuk pranoj të heq dorë prej Republikës, këtë e ka thënë Hashim Thaçi dhe pastaj përmes televizorit e kemi mësuar katër ditë pas, në një të diele që Hashim Thaçi paska pranuar të heqë dorë nga Republika, pa hequr dorë askush tjetër prej saj dhe pastaj ka pranuar po ashtu që në fusnotë ta përmend edhe Rezolutën 1244, duke ia shtuar kështu pushtetin ekzekutiv edhe juridik kësaj rezolute përmbi Kosovë, të njëjtin dokument që i njëjti person e quante për një kohë shumë të gjatë dokument të vdekur.

Pra, si mund t'ju besojmë ne tash që këto fjalë që i the sot, që nuk do të ketë kësti e nuk do të ketë asi, vërtet janë fjalë të cilat ti do t'ia thuash edhe Daçiqit, për shkak se këto të tjerat nuk i mbajtur asnjë. Pra nuk kemi ne mundësi për të besuar ty për shkak se na ke rrejt shumë edhe shpesh për të njëjtin dialog me Serbinë.

Tjetër? E përmendi edhe zotëri Kuçi, por edhe kryeministri se Kushtetuta nuk do të shkelet në asnjë mënyrë, por në të njëjtën kohë, i njëjti kryeministër na tha që tashmë ka pranuar që zgjedhjet në Kosovë të organizohen nga OSBE-ja, për pjesë të caktuar të territorit, natyrisht. Po ua lexoj tash nenin e Kushtetutës se me gjasë nuk e keni lexuar një kohë të gjatë e nuk po dini çka ka në te. Neni 139, pika e parë, KQZ-ja është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me proceset e zgjedhjeve e referendumit dhe shpall rezultatet e tyre. Pra, tash kjo KQZ-ja na u bë në të njëjtën Kushtetutë OSBE për një pjesë të caktuar të territorit, duke mos u shkelur fare Kushtetutën. Unë s' di qysh ndryshe shkelet Kushtetuta nëse jo kështu, se kjo është shkelje me dy këmbë e Kushtetutës. Në këtë pikë po flas, ka edhe shumë pika tjera, por në këtë pikë që e përmendën disa këtu, pranimi ynë që OSBE-ja t'i organizojë zgjedhjet atje, është shkelje e Kushtetutës edhe shkelje shumë e rëndë e Kushtetutës.

Desha vetëm edhe një çështje për ta ngritur këtu se është dëgjuar nganjëherë, bile ditëve të kaluara nga kryeministri, t'i ketë raportuar ose të ketë deklaruar për media që asociacioni i komunave, do të jetë vetëm një OJQ, pra një organizatë joqeveritare, e cila sigurisht do të funksionojë sipas Ligjit për lirinë e asociimit në Kosovë, meqenëse s' po i shkelim ligjet e Kosovës, apo jo. Dhe tash po na thuhet që kjo OJQ është krijuar dhe do



t'i marrë pra kompetencat, do t'i shkruhet statuti i kësaj OJQ-je në negociata me Daçiqin, pra deri këtu paska shkuar puna, sa organizatat joqeveritare në Kosovë, do të krijohen në takime të nivelit kaq të lartë mes të kryeministrit të Kosovës dhe të Serbisë, a është e vërtetë kjo?

Pra për Bruksel po shkoni për të krijuar OJQ, krijoni edhe një kundër varfërisë pra, me qenë se po shkoni atje, krijoni edhe do OJQ tjera të nevojshme për Kosovën, pasi që kjo qenka detyra e juaj. Unë nuk kam dëgjuar asnjë vend demokratik që kryeministri merret me krijimin e OJQ-ve, bile, bile kur kryeministri krijon OJQ, ato më s' janë OJQ, që nuk janë organizata joqeveritare apo jo, janë organizata qeveritare se po krijuaka kryeministri.

Pra, a je ti që s' je kryeministër e po shitesh si i tillë, apo kjo s'do të jetë që po i krijon ti? T'i definojmë disa gjëra dhe pastaj në të njëjtin fjalim, kryeministri na thotë janë diskutime, dialog a si e tha shumë të rënda, çka, aq rënd qenka për të krijuar OJQ, aq vështirë qenka për të krijuar një OJQ në Kosovë, kjo është vërtet tallje, ky është cirk dhe ja ku është protagonist kryesor i cirkut, ky këtu mbas këtu mbrapa që po qeshë. Dhe për fund ta paramendojmë vetëm një herë për pesë sekonda, nëse kemi mundësi, deputetë të nderuar se çka do të ndodhte po të mos shkonte Hashim Thaçi në Bruksel, në negociata vetëm për pesë sekonda. Çka do të ndodhte se kryeministri e tha edhe unë këtu po dua t'i besoj edhe i besoj që nuk ka dëshirë të shkojë në negociata, edhe këtu vërtet pajtohem, mbase edhe nuk ke dëshirë, sigurisht që nuk ka dëshirë të shkojë në negociata, por ama ky kryeministër ka nevojë të shkojë në negociata, këtu edhe është problemi, se ky nuk është kurrfarë kryeministri tjetër pos kryeministër i negociatave.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë 31 kompakt disqe, pra CD-ja me përgjimet të cilat disa prej tyre i kemi dëgjuar ne këto, paramendoni ne e kemi dëgjuar vetëm një pjesë shumë të vogël të këtyre përgjimeve që janë 31 CD-ja, plotësisht. Sigurisht nga sa megabajt i kanë a thua, nga 700 që nënkupton shumë përgjime dhe në këto natyrisht se ka shumë informata për këtë kryeministër dhe kjo është nevoja që e ka ky për të shkuar atje, për shkak se është i korruptuar dhe si i korruptuar është i shantazhuar dhe shantazhi tash po dihet qysh po vjen edhe pse. Por, kjo kur na thuhet që kemi trysni ndërkombëtare, kjo në fakt është ky shantazhi që po e dëgjojmë nëpër CD-ja dhe prandaj ky kryeministër është kryeministër i negociatave edhe nuk mund të jetë tjetër se nuk mund të ketë tjetër kryeministër, i cili shkon në negociata me Daçiqin, edhe pranon çfarëdo që kërkon Serbia për Kosovën. Prandaj, nëse keni paramenduar për këto pesë minuta, tash besoj e keni shumë më të lehtë ta mendoni se pse është ky kryeministër i negociatave, edhe pse ky kur nuk do t'i thotë jo këtyre negociatave sado që kërkohet të vazhdohen ato. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

**MUHAMET MUSTAFA:** I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar.

Unë në fakt nuk kisha ndërmend sot që të diskutoj, por kjo që tha zëvendëskryeministri lidhur me kompetencat e asociacionit, më shtyri pak që të diskutoj edhe eventualisht ta sqarojmë çështjen për kompetencat, sepse po më duket se kompetencat që do t'i ketë

asociacioni apo tendenca që ky asociacion tash edhe më vonë në një proces të fitojë kompetenca të caktuara, është rreziku themelor i këtyre bisedimeve.

Është e qartë se formimi i asociacionit të komunave si një mundësi, del nga plani gjithëpërfshirës dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale, siç u tha edhe këtu, por kur është paraparë kjo mundësi edhe në planin e Ahtisarit dhe në ligjin tonë, është nënkuptuar se plani i Ahtisarit duhet të zbatohet në gjithë territorin e Kosovës, prandaj ne nuk mund të kemi, merre një pjesë të planit të Ahtisarit e zbatoje, një pjesë tjetër mos e zbat. Planin e Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës është një tërësi që duhet të zbatohet si e tërë. Në qoftë se plani i Ahtisarit zbatohet për asociacionin, duhet të zbatohet edhe për ABCD, për gjithçka përmban ky plani i Ahtisarit. Kjo është esenciale.

Ne jemi të vetëdijshëm, unë dhe besoj të gjithë ne këtu jemi të vetëdijshëm se në kushtet normale kur pushteti ynë është i shtrimë në veri, kur pranohet autoriteti i këtij pushteti dhe kur nuk kemi probleme të tilla, një asociacion i tillë me të vërtetë nuk do të duhej të ishte një problem dhe nuk do të duhej madje të ishte as objekt i negociatave kaq të rënda edhe vendimeve kaq të vështira për arsye se është asociacion, është në ligjin tonë. Pse atëherë është e vështirë kjo? Ku qëndron problemi me këtë asociacion? Problemi qëndron pse në këto bisedime si duket ka tendencë edhe pse nuk po thuhet që këtij asociacioni t'i përshkruhen kompetencat, pikërisht te kompetencat dhe këtu duhet të jemi shumë të vëmendshëm. Çfarë kompetencash mund të ketë ky asociacion, kompetencat që i kanë asociacionet tjera, çfarë kompetencash ka asociacioni i komunave të Kosovës, çfarë kompetencash ka asociacioni i komunave të Serbisë, ose asociacionet e komunave tjera? Këto kompetenca le t'i ketë, por unë mendoj që kjo që tha, nuk di ndoshta as nuk e kam kuptuar, kjo që e tha zëvendëskryeministri se ky asociacion do të ketë kompetenca që ka pushteti lokal, pikërisht këtu është problemi, pikërisht këtu mund të jetë një problem shumë i madh. Pse? Sepse komunat e Kosovës kanë autorizime shumë të mëdha, komunat me shumicë serbe kanë autorizime shtesë dy - tri komuna me popullsi serbe kanë autorizime dhe përtej kësaj shtese. Në qoftë se këtij asociacioni ne në mënyrë eksenzive ia përshkruajmë të gjitha këto kompetenca që i kanë këto, rreziku është shumë potencial.

Në planin e Ahtisarit thuhet se asociacioni nuk mund të ketë kompetenca që i ka pushteti lokal, pra ky asociacion s' ka çka merret me ato çështje me të cilat vendosin komunat. Asociacioni ka një rol të koordinimit, bashkërenditjes një projekt të përbashkët, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Në qoftë se nuk dimë cilat kompetenca ka asociacione të tilla, ka asociacione tjera në Serbi, ka asociacione të tilla në Kosovë, ka në Evropë, merrni çka kanë asociacionet. Edhe unë mendoj që ne mund të qeshim me të vërtetë gjithë ditën mund të qeshim, por nuk është puna shumë për të qeshur. Prandaj le t'i gjejnë këto çka janë asociacionet, dihet çka është asociacioni, dihet çka është niveli i tretë i pushtetit, dihet çka janë kompetencat dhe këtu nuk kemi nevojë ta bëjmë. Unë e di që as kryeministri e as zëvendëskryeministri nuk donë dhe kanë për të luftuar të mos i ketë ato kompetenca, jam i bindur, mirëpo ne këtu po bisedojmë që si të përgatitemi, si të mbështetim, si të dalim prej kësaj situatë që është e vështirë dhe nuk kemi nevojë të qeshim as njëri-tjetrin ta rëndojmë këtu. Prandaj, në këtë situatë pikërisht është me vend ajo që tha zoti Sabri Hamiti, mos ta marrë kryeministri krejt përgjegjësinë dhe vendimet e

vështira, as zëvendëskryeministri, as zoti Shala, nuk po e shoh këtu, si duket ajo tavolina pak mu bë pak e dyshimtë, ajo tavolina që e përmendi sot ky Gjini, s' di apo do të jetë Shala në tavolinë, a kush duhet të jetë në tavolinë aty, Gjini apo kush?

Besoj që, sigurisht kjo çështje zgjidhet mbasandaj. Prandaj, ne jse kjo pak nganjëherë për t'u relaksuar, por nuk është për t'u relaksuar, prandaj në këtë drejtim mendoj se çështjet janë relativisht të qarta dhe ne duhet t'i bashkojmë forcat për ta kapërcyer këtë fazë të vështirë. Kjo është esenca. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

**VJOSA OSMANI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të provoj të flas shkurt.

Do të kërkoj si gjithnjë disa sqarime nga ana e kryeministrit në këtë proces të raportimit. E para ka të bëjë me strukturat ilegale. Mua po më vjen mirë që pas insistimit të LDK-së, në seancën e kaluar që shpërbërja e strukturave ilegale në veri të Kosovës të afatizohet, tashmë një ide e tillë është paraqitur edhe nga kryeministri në Bruksel, së paku ashtu u tha, mirëpo neve na duhet sqarim edhe më tej se çfarë afati konkret ka kërkuar apo planifikon të kërkojë kryeministri, kjo nën një dhe nën dy, në qoftë se ky afat përveç që i caktohet Serbisë, po ashtu do të kërkohej edhe nga EULEX-i si një institucion që bashkë me institucionet e Kosovës do të punojë në shpërbërjen e strukturave ilegale.

E dyta, a mund ta sqarojë kryeministri në qoftë se procesi i legjitimitetit të një pjese të strukturave në veri të Kosovës, do të përfshijë edhe të ashtuquajturin Këshill Nacional Serb.

E treta, a mund ta sqarojë kryeministri, duke i numëruar saktë të cilat struktura planifikohet të legalizohen dhe cilat të shpërbëhen, sepse u përmend këtu që të sigurisë tentohet që të shpërbëhen, mirëpo kërkoj nga kryeministri që t'i numërojë saktësisht cilat, më falni të shpërbëhen ato sigurisë kuptohet, kurse të legalizohet një pjesë e tyre, është mirë që të numërohen një nga një të cilat pritet të legalizohen me qenë se po përflitet një numër i tyre, është mirë që në këtë Parlament ta dëgjojmë Kryeministrin.

Sa i përket gjykatave, Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shprehur qëndrimin edhe më herët që gjykatat në veri, duhet domosdo të punojnë vetëm në kuadër të sistemit unik gjyqësor të Republikës së Kosovës. Rreziku më i madh do të ishte në qoftë se ofrohet apo pranohet diçka e cila është në kundërshtim me Ligjin e ri për gjykatat, i cili në mënyrë shumë të qartë përcakton strukturën, siç u tha edhe më herët që në komunat si Zveçan apo Laposaviq, mund të ketë vetëm e vetëm degë të Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Sa i përket asociacionit të komunave, dihet shumë qartë që këto asociacione mund të krijohen vetëm në baza vullnetare dhe ato nuk ka nevojë të imponohen, mirëpo pyetja ime është nëse ajo që ju po thonë është vërtetë në përputhje me Kushtetutën, atëherë pse ka nevojë dhe ekziston veç një zgjidhje e tillë, atëherë pse paska nevojë zgjidhjet që ekzistojnë tashmë të negociohen me dike tjetër?

Kryeministri, me qenë se u shprehën shqetësime nga një numër deputetësh, duhet ta sqarojë a do të lejohet që kompetencat e zgjeruara të komunave, sepse dihet që Komuna e Mitrovicës Veriore e paraparë me pakon e Ahtisarit, ka kompetenca më shumë se edhe disa komuna tjera serbe që janë formuara. A do të mund këto komuna t'i bartin apo delegojnë këto kompetenca në nivel të këtij asociacioni? Kjo është një prej shqetësimeve kryesore të deputetëve që duhet domosdo të sqarohet sot. Përfundimisht një brengë jashtëzakonisht e madhe sa i përket krijimit të asociacioneve të tilla, është se ato do të jenë monoetnike dhe do të qojnë jo te integrimi i serbeve të veriut, mirëpo ndarjet në baza etnike do të qojnë edhe tek ndarje më të mëdha, sepse do ta kemi një asociacion vetëm serbë, në asociacion vetëm shqiptarë dhe ndarjet e tilla assesi nuk qojnë tek normalizimi, por qojnë tek ndarjet edhe më të thella në mes të etnive në Kosovë.

Sa i përket zgjedhjeve në veri që u përmend, kryeministri është mirë ta sqarojë në qoftë se është vendosur përfundimisht periudhën kur do të mbahen zgjedhjet në veri dhe e dyta, ta sqarojë rolin e OSBE-së, sepse është thënë që OSBE-ja do të ftohet, mirëpo ne të gjithë e dimë që sipas nenit 20 të Kushtetutës, delegimin e kompetencave të një organizatë ndërkombëtare sa i përket çështjeve të ndryshme shtetërore, qoftë edhe organizimin e zgjedhjeve, mund ta bëjë vetëm e vetëm Kuvendi i Kosovës me ratifikim. Pra, pyetja konkrete është: A do të vijë ky delegim i kompetencave të OSBE-ja në Kuvend për ratifikim?

Përfundimisht, zëvendëskryeministër me qenë se kryeministri nuk qenka këtu, mua më duhet ta shpreh një shqetësim që ka të bëjë me një temë të nuk po adresohet, së paku jo publikisht, sepse unë shpresoj që ju e adresoni, ka të bëjë me të drejtat e shqiptarëve në veri. Mua më intereson cilat janë aranzhimet për popullatën shqiptare në veri? Si do të rregullohet kthimi i shtëpive dhe banesave të uzurpuara të shqiptarëve nga serbët? Si do të rregullohet kthimi i shqiptarëve, cilët hapa konkret a ka strategji, a ka plan që kërkohet në këtë proces që do të rezultonte me kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre? Si do të jetë përfaqësimi i shqiptarëve që jetojnë në veri në komunat, në kuvendet komunale, madje edhe në këtë asociacion, në gjykatat, në institucionet e tjera publike, në shkolla dhe në çdo institucion tjetër që parashihet me ligj? Pra, a është menduar edhe për ta apo po mendohet vetëm e vetëm për të drejtat e serbëve? Unë mendoj që duhet urgjentisht kjo çështje të shtrohet nga ana e kryeministrit, sepse njëjtë siç po flitet për të drejtat e komuniteteve tjera në pjesë tjera të Kosovës, nuk duhet të harrojmë që ekzistojnë me mijëra familje shqiptare që janë dëbuar nga veriu dhe ata duhet të kenë të drejta edhe të përfaqësimit, por mbi të gjitha duhet e drejta e tyre e lëvizjes së lirë dhe e drejta e tyre në pronë të garantohet.

Përfundimisht zoti Kuçi, zoti zëvendëskryeministër ju e përmendët një dokument të shkruar që e keni ndarë me zonjën Eshton, pyetja ime është: Në qoftë se e ndani me zonjën Eshton, pse nuk mundeni ta ndani edhe me deputetët e Kuvendit të Kosovës? Krejt çka po flitet këtu, do të mbetet vetëm nivel spekulimesh nëse ne nuk kemi asgjë të shkruar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ky kryeministër pat thënë që nuk do të ketë dialog politik me Serbinë, por vetëm dialog teknik me qenë se dialogu politik ka përfunduar në Vjenë dhe mandej me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Ky kryeministër pat thënë edhe që kurrë nuk do të dialogohet për veriun e Kosovës. Tash kemi përfunduar të dialogu politik me Serbinë që nuk është vetëm për veriun e Kosovës.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës, që ende i mbani shpresat te ky kryeministër, edhe sa herë duhet të na gënjejë kryeministri Thaçi, që ta kuptoni se bëhet fjalë për një gënjeshtar. Tashmë gënjeshtret e tij më të reja nuk flasin asgjë të re për karakterin e tij, sepse karakteri i tij prej gënjeshtari prodhon vetëm se gënjeshttra të reja, madje se këto gënjeshttra janë të reja, nuk jam aq i sigurt e për atë se janë gënjeshttra, s' kam asnjë dyshim...

Sa i përket agjendës dhe temave në Bruksel...,

*(Kryetari: Deputet, kursehu sa të mundesh, ta kesh parasysh fjalorin parlamentar!)*

...cilat janë ato tema që i ka propozuar kryeministri Thaçi në dialog me Serbinë dhe janë pranuar, e cilat janë refuzuar dhe ato që janë refuzuar, nga kush u refuzuan, nga Eshton apo nga Daçiq dhe me çfarë arsyetimi? Pse nuk është bërë temë ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë, për shembull, sidomos aty ku thuhet që Kosova është pjesë integrale e Serbisë, pse nuk është bërë temë data kur Serbia do të na kërkoj falje, do të na i paguaj dëmshpërblimet e luftës, do të na i kthej të pagjeturit, do të na i dorëzoj kriminelët serb të luftës e të tjera e të tjera? Pse nuk u fol për datat kur do të realizohen këto dhe shumë të tjera? S' ka asnjë përgjigje, ose ky nuk i shtron këto tema, ose ia kanë refuzuar, nëse ia kanë refuzuar kush dhe pse, nëse nuk i shtron, pse?

Njerëzit në jetën e tyre të përditshme duke qenë subjekte vazhdimisht vendosin kushtëzimin në marrëdhëniet me njëri- tjetrin. Kushte vendosin subjektet, sepse janë subjekte. Edhe subjektet e ndryshme politike në Kosovë, i vënë kushte njëri-tjetrit, edhe pozita rregullisht i vë kushte opozitës edhe opozita përpiqet t'i vë kushte pozitës edhe partia kryesore në pozitë i vë kushte partnerëve më të vegjël të koalicionit qeverisës, madje edhe këta partnerë më të vegjël qeverisës po i vënë kushte partisë së kryeministrit. Pra, kushte e kushtëzime gjithandej, secili secilit tërë kohën për shumëçka. Mirëpo, deputetë të Kuvendit të Kosovës, a e keni vërejtur qysh Serbisë thuhet se nuk bënë t'i vënë kushte, me Serbinë duhet të hyjmë në dialog pa kushte na thënë këta, njëri- tjetrin kushtëzoni sa të doni, kur të doni, për çka të doni, por Serbinë asnjëherë për asgjë. Nuk ka më keq se kaq, nuk ka më poshtë se kaq.

Të gjithë e dimë që struktura ilegale ka edhe në Shtërpcë e në Ranillug, ato janë toleruar, tash këso toleromi do t'iu bëhet edhe atyre në veri të Kosovës si rezultat i këtij dialogu në Bruksel, veç se atje Daçiqi do edhe kompetenca shtesë përveç legalizimit dhe hegjemoni të pranuar përmes asociacionit a bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Qeveria e Kosovës duke bashkëjetuar me strukturat ilegale të Serbisë në komunat me shumicë

serbe, sipas Ahtisarit e në jug të Ibrit e ka sajuar mundësinë për sovranitet të ndarë me Serbinë në Kosovë e në të cilin bazohet tash kërkesa e Serbisë për bashkësinë e komunave serbe në Kosovë.

Pra, vetë bashkëjetesa e kësaj Qeverie me strukturat ilegale që janë edhe në Graçanicë edhe në Partesh edhe në Ranillug edhe në Shtërpcë edhe në Gorazhdec, ka bërë që të inkurajohet Serbia për kërkesën mbi bashkësinë e komunave serbe në Kosovë, për kompetenca shtesë e për legalizim të tyre.

Beogradi e ka krijuar bashkësinë e komunave shqiptare të Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit që e kontrollon përmes trupit koordinues për jugun e Serbisë të drejtuar nga Zoran Stankoviqi, tash po e do edhe bashkësinë e komunave serbe në Kosovë dhe kontrollin mbi të. Thjesht dialogu politik me Serbinë në Bruksel për Kosovën, me vetë qenien e tij si dialog i jep të drejtë Serbisë kur ajo refuzoi pavarësinë dhe planin e Ahtisarit. Çështja mbetet e hapur, domethënë ishte mbyllur gabimisht. Përpos arsyetimeve të vjetra për integrim evropian, njohje reciproke, integrim të serbëve e gjepura të ngjashme, pas takimit të pestë me Daçiqin, kemi dukurinë e obskurantizmit qeveritar si argument. Për çfarë obskurantizmi e kam fjalën? Ai shprehet kështu: “Asgjë e re nuk po ndodhë, asociacionin e parasheh edhe plani i Ahtisarit”. Në fakt po ngjajnë interpretime ultraliberale të planit të Ahtisarit në favor të Serbisë. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, së paku është dashur që interpretimi i planit të Ahtisarit, të bëhet nga institucionet e Kosovës në Prishtinë e jo nga Serbia e Daçiqit në Bruksel. Thaçi thotë se gjithçka është në përputhje me Kushtetutën, mirëpo kështu ai po i bën interpretim personal arbitrar asaj.

Jo vetëm që ky kryeministër po merret vesh për asociacionin e komunave me shumicë serbe, por këtë gjë po e bënë në marrëveshje me Daçiqin dhe me Serbinë. Nëse konsiderohet që na qenka e nevojshme dhe e vlefshme një asociacion i tillë, atëherë pse ai nuk po bëhet në Prishtinë me kryetarët e këtyre komunave e jo në Bruksel me Daçiqin? Pra, me vetë faktin që po niset ky asociacion me Daçiqin, Serbia po bëhet hisedare për çështje të brendshme të Kosovës me pëlqimin e Qeverisë së Kosovës, për më tepër ideja e këtij asociacioni, buron nga platforma e Serbisë për të cilën Thaçi para disa javëve tha që nuk do të jetë assesi në tavolinën e dialogut në Bruksel, mirëpo kjo ndodhi. Ky asociacion që Serbia e quana bashkim, u shfaq si interes i Serbisë së Daçiqit dhe tash kryeministri Thaçi po shfaqet si bashkëpunëtorë i Serbisë në realizimin e interesave të saja.

Pranimi i këtij asociacioni është gjithsesi tradhti ndaj shtetit të Kosovës dhe ndaj Republikës sonë, mirëpo kjo nuk është më e rënda, pra nuk është më e rënda që Thaçi do të bëhet tradhtar, më e rënda është që Thaçi tashmë është bashkëpunëtor i Serbisë, sepse tradhtia andaj shtetit të Kosovës ndodh një herë si akt, ndërsa bashkëpunimi me Serbinë ndodh vazhdimisht si një proces. Nuk është bashkëpunëtor me Serbinë vetëm ai që para luftës ose gjatë luftës raportonte në stacion policor se kush ka armatim në fshat ose kush po shpërndan trakte armiqësore, bashkëpunëtor është edhe ai sot i cili merret vesh me Daçiqin për çështje të brendshme të Kosovës e për interesa të Serbisë.

Marrëveshjet me Serbinë në Bruksel, janë marrëveshje personale të Thaçit, Daçiçi ndoshta e përfaqëson Serbinë, jo edhe Thaçi Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Hoxhaj e ka fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar!

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj

Në këtë seancë të vonshme të Kuvendit të Kosovës, sot debatua shumë gjatë për formën edhe për përmbajtjen e asociacionit të komunave për substancën e tij dhe me thënë të drejtën, unë i kuptoj edhe shumë shqetësime dhe shumë dilema që u ngritën, por besoj që kryeministri i Kosovës edhe zëvendëskryeministri, në qartësi të plotë ofruan një pamje që nuk do të ketë nivel të tretë, nuk do të ketë asimetri përkundër asaj që fenomene të tilla, delegacionin e Kosovës e kanë përcjell në Vjenë dhe përkundër asaj që fenomenet e tilla që na kanë përcjell në Vjenë, asnjëherë nuk ka ndodhur.

Më lejoni që të dal pakëz jashtë asociacionit të komunës se kemi hyrë vetëm në asociacion të komunave. Më lejoni t'i përmend disa aspekte kyçe se çka nënkupton një proces i tillë për Republikën e Kosovës. Së pari dialogu për normalizimin e relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është shndërruar ndërkombëtarisht në një argument të fuqishëm që Serbia po e pranon realitetin dhe dua të jemi të qartë, po pranon realitetin e Kosovës së pavarur.

Unë e di që ne kemi pasur këto dy vjetët e fundit debate të shumta edhe për pjesën teknike të dialogut edhe për këtë dialogun tash, por më lejoni vetëm t'i përmend disa shembuj konkret. Përmes Marrëveshjes kadastrave, Serbia e ka pranuar Gjykatën Supreme si autoritet final të Kosovës, përmes Marrëveshjes së auto-targave, Serbia e ka pranuar Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, si autoritet i vetëm që lëshon targa, përmes Marrëveshjes rajonale dhe ne dje u anëtarësua në Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit, Serbia ka pranuar që Kosova të përfaqësohet, të anëtarësohet, të nënshkruajë dhe të flasë në emrin e saj në të gjitha organizatat rajonale, përmes Marrëveshjes së IBM. Serbia e ka pranuar kufirin ndërshtetëror të Kosovës, ka pranuar që Kosova ta kontrollojë kufirin, që mallrat të tatimohen dhe doganat të respektohen me ligje të Kosovës, dhe së fundi përmes marrëveshjes për Zyrën Ndërlidhëse, Serbia ka pranuar që të shkëmbejmë diplomatë në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe mendoj që këto marrëveshje duhet të shihen, duhet të lexohen dhe duhet të interpretohen pikërisht në këtë formë.

Së dyti, u përmend shumë këtu çështja e dialogut a duhet të hyjë në dialog apo nuk duhet të hyjë në dialog. Për Republikën e Kosovës është shumë kyç që të dëshmojë çdo ditë që dialogun e kupton si instrument civilizues, që dialogu është vlerë evropiane dhe vlerë perëndimore dhe përmes dialogut sikurse çdo herë dhe sidomos në këto dy dekadat e

fundit, kemi triumfuar në histori, përmes dialogut ne do ta kemi mundësinë edhe kësaj here të fitojmë në tavolinë, siç ka qenë në Rambuje, siç ka qenë në Vjenë edhe kësaj here nuk duhet t'i ikim dialogut, por përmes tij ta shtyjmë agjendën tonë të shtetndërtimit.

Së treti, dialogu është praktikë diplomatike dhe në rrafshin e Kosovës, dialogu është një dialog bilateral, dialogu është mundësia më e mirë që dëshmon që ka reciprocitet diplomatik dhe mbi të gjitha, dialogu neve na mundëson edhe në Bruksel që ta ushtrojmë atë se çfarë thirret si sovranitet i jashtëm. Një shtet modern ka nevojë të demonstrojë dhe Kosova po demonstroi që ka kapacitet të saj për të dialoguar me Serbinë duke e shtyrë agjendën e saj nacionale.

Së katërti, agjenda jonë nacionale është integrimi i veriut. Ne duhet të jemi shumë real për 13 vjet të lirisë dhe për 5 vjet të pavarësisë, ne nuk kemi qenë në gjendje që ta reintegrojmë veriun e Kosovës dhe ky dialog ka të bëjë edhe me ushtrimin e sovranitetit të brendshëm të Kosovës. Është fjala për stabilizimin e brendshëm të Kosovës, është fjala po edhe për stabilitetin e rajonit si i tillë.

Unë e di që në këtë sallë, në këto dy vjetët e fundit dhe në opinionin publik, ka pasur çdo herë argumente që dialogu do ta bllokojë procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Në vitin 2012, kemi pasur 13 njohje që besoj se është argument i fuqishëm që dialogu nuk ka mund ta stopojë një proces të tillë. Ka pasur po ashtu argumente që dialogu do ta bllokojë Kosovën në anëtarësimin e saj në organizatat rajonale, evropiane apo ndërkombëtare dhe ne i kemi parë në fund të 2012, që përkundër asaj që kemi qenë në dialog, jemi anëtarësuar në Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, në të cilën bankë ne jemi anëtarësuar si Republikë e Kosovës dhe për anëtarësimin tonë, këtu votën e kanë dhënë edhe Greqia edhe Sllovakia edhe Egjipti edhe Izraeli edhe Tunizia edhe Maroku, shtete që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, do të thotë dialogun duhet ta shohim dhe ta kuptojmë në një formë se si edhe po ndodh. Dhe së fundi, dialogu është për ne shumë kyç që ta shtyjmë agjendën tonë evropiane. Mos të mendojë dikush në këtë sallë që Republika e Kosovës do të mund të nënshkruante marrëveshje të stabilizim-asociimi, e cila për neve është kyçe jo vetëm në agjendën e integriteteve evropiane, por për neve është marrëdhënie kontraktuale në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian nëse ne, në këtë dialog për interes tonin edhe nacional edhe evropian, nuk e shtyjmë në agjendë të tillë. Në këtë drejtim, unë ju ftoj juve përkundër shqetësimeve që i keni që dilni pakëz prej asociacionit të komunave, se ma merr mendja që në këtë të premte në këtë fundjavë i kemi kushtuar goxha shumë vëmendje një asociacioni i cili nuk është krijesë e vitit 2013 por për neve që kemi qenë në Vjenë e dimë që ka qenë pikërisht krijesë e vitit 2006 dhe 2007 të një procesi i cili e ka sjellë pavarësinë e Kosovës.

**KRYETARI:** Lutfi Haziri e ka fjalën.

**LUTFI HAZIRI:** Faleminderit, kryetar!

Nënkryetar i Kuvendit,

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë, të këtyre orëve të vona, më falni edhe për shkak të shëndetit, të konfirmoj që interesi i madh të jem këtu, më ka bërë që të marrë pjesë në këtë diskutim,



normalisht duke respektuar dhe duke e çmuar gatishmërinë për të raportuar dhe për ndërtuar marrëdhënie raporti, marrëdhënie institucional mes ekzekutivit si i mandatuar dhe legjislativit si organ i kontrollit në këtë rast, edhe pse, po e përsëris edhe një herë, pa dashje në këto procese po kanë qejf të marrin pjesë shumë tjerë dhe t' i bëjnë pandan shpeshherë edhe kryeministrit edhe Qeverisë, siç ishte rasti i takimit në mes presidentëve që për t' i kontribuar normalitetit, duhet bërë edhe një pjesëmarrje tjetër.

Sidoqoftë, besoj se ky mandat po ecë në drejtim të përfundimit sipas orarit që janë përcaktuar dhe normaliteti po del në kuadër të kornizës evropiane të procesit e jo në kuadër të normalitetit mes shqiptarëve dhe serbëve.

Ky është dallim i madh, sepse shumica e deputetëve po i mëshojnë temës së normalitetit në mes marrëdhënieve të Serbisë e të Kosovës për deri sa normaliteti dhe ky dialog, dhe ky "normalitet" është në kuadër të kornizës evropiane apo të procesit integrues evropian të Kosovës dhe të Serbisë dhe dallon shumë. Parimi i Kopenhagës, në normalitet dhe gjendja e luftës mes Kosovës dhe Serbisë janë dallime të mëdha.

Mendoj se koha do ta dëshmojë që me normalitet de fakto do të merremi në rrethana tjera, por ky proces po shkon në drejtim të përmbylljes, në muajt e ardhshëm do të vendosë së paku minimumin e raporteve në mes dy vendeve për të mos penguar njëri-tjetrin në procesin e integriteteve.

Ky është dallim i madh dhe ju lus që ta keni parasysh, sepse nuk mund ta mohojmë sado që ministrat e Kabinetit qeveritar po donë ta betonojnë qëndrimin e kryeministrit se dialogu po shkon në drejtimin e duhur, deri sot secili prej neve nuk ka nevojë të bindet më shumë, sepse po e shohim temat janë në favor tonin, temat janë në interes tonin, por gjithkund është thënë se kemi hyrë tash në tema të nxehta dhe temat e nxehta dhe temat e nxehta gjithmonë nënkuptojnë temat e disfavorshme apo temat që janë problematike për ne.

Gjithmonë temave problematike iu kemi frikuar, iu kemi frikuar aq shumë sa që sa diskutuam e debatuam për 10 shkurtin njerëzit prej frikës së madhe edhe kanë humbur jetën. Kanë humbur jetën nga dhuna e paplanifikuar dhe e tejkaluar, duke dashur ta mbrojnë të drejtën, sepse janë frikuar që po humbin. Nuk ka nevojë të ndjellim frikë në këtë raport, por nuk ka nevojë as të ofruar siguri totale se krejt temat dhe gjithçka procesi është në rregull.

Pse po e them këtë? Unë jam njëri prej të parëve që kam thënë që asociacioni i komunave të Kosovës iu ka dashur Kosovës dhe unë jam njëri prej t themeluesve. Në atë kohë Qeveria ku ka qenë Bajram Rexhepi, nuk e di a është këtu, kryeministri e ka marrë me skepticizëm të madh mënyrën alternative të organizimit të drejtave dhe mbrojtjes së të drejtave. Po është vendosur në parimin e multipartizmit dhe multietnicitetit, në mënyrë që të përfaqësohen të gjithë, të gjitha komunat dhe unë kam qenë kryetar i parë, nënkryetari i parë ka qenë zoti Ramadan Gashi prej PDK-së dhe nënkryetari i tretë ka qenë kryetari i Leposaviqit, Nenad Radosavleviq. Dhe, kjo formulë e zhvillimit ka qenë.

Tash, asociacioni i komunave me shumicë serbe si organizim i veçantë monoetnik dhe si kërkesë për t'i mbrojtur të drejtat specifike të tyre është problem i tyre nëse donë ta bëjnë, po është non sens për të negociuar për një të drejtë që e garanton Kushtetuta. Kushtetuta e jep këtë të drejtë, tri a më shumë komuna mund nesër të organizojnë asociacione pa asnjë problem se ligji nuk mund t'ua ndalë në Kosovë.

Konventa Evropiane të cilës ne i referohemi si bazë ua lejon këtë mundësi dhe ata mund të organizohen. Në dy parime, në parimin e parë të partneritetit ndërkomunal për të gjitha kompetencat e veta dhe nën dy parimin e bashkëpunimit ndërkufitar, në të gjitha kompetencat e veta, dhe këtu nuk kemi nevojë të dyshojmë.

Ekziston një bashkëpunim ndërkufitar që njihet si GJPKT, i cili i ka 17 komuna, por që është në lindje të Kosovës, ku marrin pjesë komunat e Kosovës, të Serbisë, të Maqedonisë dhe kurrfarë problemi që 7 vjet s'i kanë bërë Kosovës, as Kosova s'i ka bërë Maqedonisë, por në rasti e veriut si problem kur nuk funksionon shteti dhe kur nuk funksionon sovraniteti, kompetencat ashtu siç thuhet nga plani i Ahtisarit, ne kemi qenë të kujdesshëm, plani i Ahtisarit thotë nuk mund të ketë partneritet jashtë, ose në kompetencat që i ushtron Qeveria.

Marrja e këtyre kompetencave atëherë krijon problemin tjetër, sepse komunat nesër nuk do të kenë mundësi t' i ndalim që për interesin e vet me të ulën për të nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi e të thonë, për këto kompetenca ne jemi marrë vesh për t'i ushtruar bashkërisht, me një staf, me një buxhet, me një zyre dhe me një autoritet.

*(Ndërhyrje)*

S'mund ua ndalë, as Gjykata Kushtetuese nesër s'do të ketë mundësi t'ia rrëzojë kjo e drejtë se është Konventë evropiane e garantuar në ushtrimin e detyrave.

Për gjithçka që është interes i tyre dhe për gjithçka që prek fushën e pushtetit lokal, sepse autonominë në pushtetin lokal e kemi garantuar, autonominë kulturore e kemi garantuar, të drejta asimetrike në shëndetësi dhe në arsim të lartë e kemi garantuar për komunat, e tash ka mbetur vetëm edhe një kërkesë që pritet të realizohet e që besoj shumë nuk është pjesë e debatit, nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje, unë dua të besoj shumë që nuk është.... kemi luftuar shumë në Vjenë, të mos lejojmë krijimin e shtresës së tretë të pushtetit.

Unë nuk po i lë emër këtij modeli, sepse Kosova është rast i veçantë, edhe zgjidhja e veriut do të jetë rast i veçantë.

Nëse më pyetni cili model është më i përafërt, është modeli i tri komunave gjermane në Belgjikë. Sipas kësaj që po flitet, po shkruhet dhe po thuhet, kjo i përngjan modelit më të afërt me të drejtat e tri komunave gjermano-folëse Mbretërisë Belge.

Por, kjo çështje që tash nuk ka nevojë për të krahasuar e të shkaktojmë frikë, unë besoj që e drejta e organizimit në mënyrë asociative do t'i lejohet, nëse donë të jenë monoetnik, le

të jenë monoetnik por duhet sqaruar një çështje që ushtrimi i të drejtave të ligjit sipas legjislacionit dhe sipas të drejtës që e kanë jashtë kompetencave të komunave nuk mund të bëjë bartje, bartje të drejtës, kjo është me rëndësi të mos lejohet bartja e të drejtës, sepse ai nesër thotë - ne jemi marrë vesh dhe dom ta ushtrojmë, zjarrfikësit e krejt veriut të jenë në një komandë, në një organizim, me një strukturë ose ku e di çfarë aktiviteti.

Në pjesën e dytë, kryeministër dua të dal jashtë Rezolutës edhe një herë dhe jashtë asaj që është thënë, ishit shumë decidivë që nuk do të lejoni asgjë jashtë Kushtetutës dhe kufijve që sot Kosova i ka, edhe një herë po ua përmendi - politikanët dhe udhëheqësit e zot në rrethana të rënda janë dëshmuar dhe dëshmohen kur merren me zgjidhjen e problemeve të rënda, dhe problemet e rënda zgjidhen nëse arrijnë t'i i konstatojmë, t'i evidentojmë dhe të ulemi e t'i zgjidhim.

Unë po e shosh se Kosova zyrtare nuk po dëshiron ta hapë asnjë lloj teme tjetër që merret me të drejtat e 100 000 shqiptarëve në Luginën e Preshevës, tashmë si term ka hyrë, apo Kosova Lindore, karshi zgjidhje së problemeve të tri komunave në veri. Tri komunat në veri nuk ka të bëjë me Mitrovicë, na të bëjë me tri komuna rurale që janë, se Mitrovica është qendër urbane dhe qendër administrative e vjetër në Kosovë, sa vetë Kosova që është e vjetër.

Por, tendenca për të ikur dhe për të lejuar që OSBE-ja t'ua zgjidhë problemet atyre atje, ndërsa këtyre me ua zgjidhur Brukseli, është debalanc i madh, i cili ka për të lejuar plagë të hapura, nuk do të shkaktojë normalitet, s'ka për të bërë kurrfarë normaliteti, por së paku nëse mbërrihet normaliteti në parimin apo në kornizën evropiane, unë do të jem i lumtur dhe kjo është arsyeja pse e mbështes këtë dialog. Po normaliteti në mes serbëve dhe shqiptarëve është proces krejt tjetër që më mirë është të fillojë tash të zgjidhët se të lihet më vonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Ndërsa po e dëgjoja ministrin Hoxhaj këtu, që po thurë këtu himne dialogut, himne dialogut, mendova që veç edhe një këngë i ka mbetur Qeverisë, ta nxjerrë për dialogun dhe ta këndojnë në kor këtu ministrat: Lavdi dialogut!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Para pak ditësh nga Koreja e largët na erdhi një deklaratë nga kryeministri i Kosovës se ai qenka pajtuar me një kërkesë të Serbisë në dialog për asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Janë disa pyetje që mund të shtrohen këtu: A ishte ky një frymëzim i tipit lunatik apo solar nga Koreja Jugore, nëse duam ta përkthejmë hënor apo diellor, Ksan Mun, një Universitet i themeluar nga njerëz të cilët pak a shumë besojnë në marrëzira, apo vetë largësia e Koresë ishte e përshtatshme për të dhënë ide të tillë të marrë, siç është kjo e pranimit të nivelit të tretë të qeverisjes.

Një kompromis i tillë së paku meriton t' u tregohet qytetarëve të këtij vendi nga institucionet e Kosovës, jo nga salla e një universiteti të dyshimtë ku të pranishmit as nuk e kanë idenë ku bie Kosova.

Mirëpo kjo nuk ka ndodhur rastësisht, përzgjedhja e vendit është bërë për t'i ikur ballafaqimit me partitë opozitare dhe me vetë opinionin publik të këtij vendi, për një lëshim të tillë.

Pyetja tjetër: A ka njeri këtu në këtë sallë dhe jashtë kësaj salle që beson se asociacioni i komunave është vetëm një OJQ, siç ka thënë kryeministri? Nuk besoj se gjithë këto përpjekje që po i bën Serbia deri tani po i bën për një OJQ.

Kam përshtypjen se këtë punën e OJQ-së as fëmijët nuk e besojnë. Ne e dimë se asociacioni i kërkuar është pjesë e platformës së Serbisë të përgatitur nga Akademia e Shkencave të këtij vendi dhe ajo që ka marrë bekimin e Parlamentit të Serbisë. Kjo platformë kërkon autonomi substanciale dhe territoriale, kërkon pavarësi në gjyqësor, polici, dogana dhe të gjitha këto elemente shtetërore dhe kategori kushtetuese. Koncesionet për këto do të çonin edhe në ndryshime kushtetuese, pra në rimodelimin e rregullimit të brendshëm të Kosovës, i cili me një rajon autonom brenda nuk mund të thotë më se ka karakter unitar.

Meqë jemi këtu, më duhet të ripërsëris se asnjë një shtet anëtar i Bashkimit Evropian apo i Këshillit të Evropës, nuk ka pranuar të shkojë kaq larg me zgjerimin e të drejtave politike sa grupeve etnike apo minoriteteve t'ju japë autonomi. Është veçanërisht e rrezikshme kjo nëpër kufij ku këto grupe kanë vazhdimësi territoriale me shtetin tjetër që ka pretendime territoriale ndaj shtetit fqinj. I tillë është rasti i Kosovës, serbëve që jetojnë në veri, të cilët kanë vazhdimësi territoriale me Serbinë.

Arsyeja dihet sepse pra çdo shtet i Bashkimit Evropian, por edhe i Këshillit të Evropës nuk ka pranuar një gjë të tillë, sepse ekziston rreziku i shpëputjes. Asociacioni i komunave serbe është pra një shtëpi. Të shohim tani se kryeministri dhe Qeveria e tij çfarë do të fusin brenda në këtë shtëpi, pra çfarë kompetencash, por ju garantoj se gjithsesi kjo është një shtëpi tjetër, nga ajo e shtetit të Kosovës.

Prandaj, deklaratat e kryeministrit se nuk ka ndonjë rrezik nga ky proces, janë vetëm për konsum politik të brendshëm, njëjtë sikurse janë deklaratat për normalizim, të cilat variojnë nga ato të zgjidhjes së konfliktit me simbol të pajtimit fusnotën, deri tek anëtarësimi në OKB, që është një iluzion tani për tani.

Argumentet se ky dialog do të sjellë njohje në OKB, besoj se të gjithë e dini se është krejtësisht i paqëndrueshëm.

Çështja tjetër që dua të trajtoj ajo që kemi dëgjuar, transformimi i strukturave ilegale, në legale.

Kam marrë vesh se grupacioni i famshëm ilegal “Rojat e Urës” do të transformohet aq shumë sa do të pësojë metamorfozë, nga kriminelë do të bëhen policë. Po, po - do të futen në radhët e Policisë së Kosovës. Kjo po që është një arritje. Të jemi të qartë, nuk mund të krahasohen këtu mësuesit apo infermierët që mund të kenë marrë rroga nga Serbia, këto vite me trupa të MUP-it, të BIA-s e tjerë, që kanë shkaktuar vrasje, për shembull vrasja e policit Enver Zymberi apo vrasja e policit ukrainas, plagosje, zjarrvënie të gjykatave të Kosovës, bomba të përnatshme, bile nuk kanë përtuar t’i japin dajak edhe trupave të KFOR-it.

Këta pra do të na bëhen ruajtësit e rendit në Kosovë. Kësaj i thanë tamam ta bësh ujkun bari të deleve. Dhe “Rojat e Urës” janë vetëm një nga grupet e rrezikshme dhe kriminale që jetojnë në veri.

Për mua transformimi i strukturave ilegale me theks të veçantë i strukturave të sigurisë, është legjitimim i vetë krimit, i veprimeve të tyre për vite me radhë. Legjitimimi si i tillë e përjashton gjendjen kriminale të 14 vjetëve, e neutralizon, e normalizon në vend që ta diferencojë e ta shpallë atë anormale, por legalizimi i krimit shkon përtej logjikës së demokracisë.

Dëgjova edhe një budallallëk tjetër sot, por nuk e di se sa është i vërtet, që në veri zgjedhjet mund të organizohen edhe me letërnjoftime të Serbisë, pra, qytetarët me letërnjoftime të lëshuara nga Serbia. A është kjo pjesë e kompromiseve të arritura në Bruksel?

Imagjinoni tani një vërshim popullate nga Serbia në veri, në mënyrë që të ndryshohet rezultati i zgjedhjeve. Çfarë sistemi është ky? Çfarë demokracie është kjo? Kjo është zgjidhja që po i sjellin bisedimet me Daçiqin.

Së fundi, e kemi thënë shumë herë se propozimi i Ahtisarit i përbrendësuar në Kushtetutën e Kosovës, dhe në ligjet që derivojnë prej saj, por i papranuar nga OKB-ja, ka shkuar deri në vijat e kuqe të funksionalitetit të shtetit, në mos i pat tejkaluar ato me eksterritorialitetin.

I gjithë ky kompromis u bë për të kënaqur Serbinë, megjithëse ajo e kishte humbur luftën me Kosovën dhe u diskreditua botërisht për politikën gjenocidale. Ndaj, dua ta pyes kryeministrin i cili ka shumë qejf të lavdërohet me luftën, sepse sillet si humbës. Mbase ai nuk e di, por është mirë ta mësojë se rregullat e pasluftës i imponojnë fitimtarët. Për më tepër që lufta e Kosovës ishte luftë çlirimtare, e moralshme dhe e drejtë.

E kam edhe një pyetje të fundit për kryeministrin. A jeni i sigurt zoti kryeministër se po raportoni të gjitha veprimet tuaja në këtë dialog këtu para Kuvendit? Faleminderit!

*Kryesimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.*

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,  
Ne deputetët që kemi votuar për vazhdimin e bisedimeve kemi të drejtë vetëm ndoshta t'i shtrojmë disa çështje më tepër në formë të pyetjeve se sa për të dhënë përgjigje, pasi ne jemi pajtuar për bisedime.

Çështja shtrohet, pse po zhvillohet ky proces i bisedimeve politike për çështje të brendshme të Kosovës? Për të rikonfirmuar dokumentet që i kemi në përdorim, sigurisht se jo, se ato janë dhe si të tilla pasi janë dhe të bisedojmë për to pasi janë, unë nuk besoj që po bisedojmë për t'i konfirmuar këto dokumente.

Nëse këtyre bisedimeve po u themi, normalizim i marrëdhënieve me Serbinë, unë këtë gjuhë të komunikimit nuk e shoh as në Beograd as në Kosovë. Pse? Në rend të parë, nuk e shoh gatishmërinë e Serbisë dhe përfaqësuesve të saj për t'i normalizuar marrëdhëniet me Kosovën.

Unë mendoj se duhet të jemi më të sigurtë me qytetarët që i përfaqësojmë. Këto bisedime nuk janë vullnet as i përfaqësuesve të Kosovës as i përfaqësuesve të Serbisë, janë bisedime që mbahen në Bruksel me mbikëqyrjen e Brukselit dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por jo pse Beogradi dhe Prishtina janë të vullnetshëm për të biseduar, por u është imponuar rruga e të dy kryeministrave për t'u integruar në institucionet evropiane.

Prandaj, kur i kemi parasysh këto, ne duhet të jemi më seriozë dhe më transparentë me qytetarët tanë, atyre ne duhet t'ua themi të vërtetën. Pse po e them këtë? Ne, disa herë, në informimet që kryeministri i bën Kuvendit, përsëritet se do të merren vendime të vështira. Kur kemi biseduar për pakon e presidentit Ahtisari edhe në Vjenë edhe në Kosovë, kemi pas thënë që ky është një dokument i dhimbshëm, i dhimbshëm por po e pranojmë për t'i hapur rrugë shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Dhe pavarësia u shpall e mbikëqyrur dhe u heq edhe mbikëqyrja.

Tash, pas gjithë këtyre bisedimet janë të vështira. Bisedimet e vështira pas atyre bisedimeve të dhimbshme dhe dokumentit të dhimbshëm që e miratuar në Kuvend, a mund të mbesim tek ajo që ishte e dhimbshme në këto bisedime. T'ju them të drejtën, unë nuk besoj që mund të mbesim tek ajo që ne e kemi quajtur të dhimbshme, e kemi pranuar dhe e kemi.

Prandaj, për këtë them, do të duhej që ta kemi edhe guximin, edhe përgjegjësinë për ta thënë atë që është, sa janë të vështira bisedimet dhe ku konsiston vështirësia e këtyre bisedimeve.

Nuk ka kuptim, absolutisht s'ka kuptim të flasim për asociacionin e komunave kur i kemi të gjitha dokumentet. Pse atëherë po flasim për diçka që e kemi dhe a ka kuptim të zhvillohen bisedime të këtij niveli për ta verifikuar atë që e kemi? Prandaj, ne si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës kemi për obligim ta dimë çka përtej këtyre vështirësive, çka përtej asaj që ishte e dhimbshme e ditëm, e tani e kemi çka prej këtyre vështirësive dhe çka prodhon ky vendim i vështirë që mund ta marrim diçka pozitive për

qytetarët e Kosovës? Mendoj se kjo duhet të dihet: çka prodhon ose çka prodhojnë këto bisedime të vështira? Ne tani për tani nuk kemi asnjë informacion për ta ditur se çka prodhojnë këto bisedime të vështira. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Ahmet Isufi. Unë ju informoj që ende janë të paraqitur dhe e presin fjalën: Anton Çuni, Rexhep Selimi, Teuta Sahatqija, Ganimete Musliu, Bekim Haxhiu dhe në këtë sekondë Shaip Muja.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një temë shumë serioze, konsideroj, por sjellja jonë është krejt joserioze në raport me temën serioze. Pse? Një temë e cila ka të bëjë me bisedimet mes dy shteteve të cilat kanë pasur raporte jashtëzakonisht kundërthënëse, edhe që po u dashkan të normalizohen.

Sjellja joserioze me këtë temë kaq serioze është se në këtë Parlament të Republikës së Kosovës, janë nxjerrë dy rezoluta një pas një të cilat obligojnë që në Parlamentin e Kosovës çdo marrëveshje e arritur të ratifikohet e që s'ka ndodhur asnjë deri më tani. Që të kemi raport nga zhvilluesit e bisedimeve dhe ky Kuvend nuk e ka marrë asnjë njoftim më të thjeshtin të shkruar se cilat kanë qenë bisedimet, cili është rezultati, cilat janë përpjekjet për ta ndryshuar gjendjen?

Po flas për diçka krejtësisht thelbësore për shkak se po bëhet ky debat kaq i gjatë dhe cili do të jetë rezultati i fundit i këtij debati rreth një informate gojore që e ofron kryeministri i vendit? Më mirë është si Parlament ta shohim vetveten dhe më mirë është ta nxjerrim një rezolutë ku i shkarkojmë këto dy rezolutat e mëparshme për të mos u bërë vërtet joserioz dhe që të mos kërkojnë të na raportojnë fare ose të na njoftojnë fare se çka po ndodh, meqë nuk kemi një raportim serioz në këtë Parlamentin.

Mendoj që nuk është çështja kaq e lehtë që me një informatë gojore të tejkalohet krejt kjo gjendje, sepse kemi të bëjmë me raporte të cilat janë jashtëzakonisht të ndërlikuara dhe kërkojnë një qasje shumë më domethënëse.

E kam këtë për shkak se po thuhet që do të merren vendime të vështira, e kur merren vendime të vështira dihet cilat janë ato dhe kush paguan çmim. Dhe për të qenë shumë të ndershëm para qytetarëve të Kosovës, është mirë që më ky Parlament mos të debatojë pa dokument para vetes, sepse vërtet po e denigrojmë edhe Parlamentin, Qeveria po e denigron vetveten që ka pranuar të marrë pjesë në këto bisedime dhe të mos bëjmë një debat koti pa asnjë rezultat në fund. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Anton Quni e ka fjalën.

**ANTON QUNI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendësministra, ministra,

Deputetë,

Fjala ime është në lidhje me shpërbërjen e strukturave paralele në veri të Kosovës. Do të fokusohem në mundësinë që mekanizmat ilegalë në veri të Kosovës, si instrumentet e

Serbisë të transferohen apo të akomodohen në kuadër të institucioneve të sigurisë së Kosovës. Më konkretisht, për akomodimin e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Mbrojtjes Civile të Republikës së Serbisë, në kuadër të Policisë së Kosovës, e ndoshta edhe të Forcave të Sigurisë së Kosovës.

Për 14 vjet radhazi, institucionet e Kosovës nuk arritën shtrirjen edhe në veri të Kosovës. Ato u penguan nga mekanizmat që u ngritën nga Qeveria e Serbisë. Tani në Bruksel po diskutohet për fatin e strukturave ilegale. Në fakt po diskutohet për shpërblimin që duhet t'u ofrojë Qeveria e Kosovës këtyre strukturave.

Të kujtojmë edhe një herë se cilat janë aktivitetet dhe format e tyre të punës: pengimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve, pengimi i zgjedhjeve demokratike, mospërfillja e institucioneve legale dhe luftimi i tyre, kërcënimi i shqiptarëve dhe boshnjakëve në atë pjesë, protestat e dhunshme, pengimi i rikthimit të banorëve shqiptarë në vatrën e tyre, incidentet me bomba dhe armë zjarri, barrikadimi i rrugëve, djegia e kalimeve kufitare, sulmet e dhunshme në pjesëtarët e Policisë dhe Doganës së Kosovës, kërcënimi dhe frikësimi i qytetarëve serbë që deklarojnë bashkëjetesën me shqiptarët, krimet ekonomike, zhvillimi i tregut të zi, trafikimet, plaçkitjet, reketimi i qytetarëve e tjera.

Në gjitha shtetet demokratike që pretendojnë të jenë të respektuara për sundimin e rendit dhe të ligjit, këto formacione luftohen pa kompromis. Është e pakuptimtë që njerëzit nga bota e krimit, banditizmit, kriminalitetit, dhunës, tani me një marrëveshje brenda natës të shndërrohen në zyrtarë të rendit dhe të ligjit. Me institucionalizimin e dhunës, terrorit, krimit, ne tregohemi të dobët para botës demokratike dhe hapim mundësinë që çdo nacionalitet problemet e tij mund t'i zgjedhë edhe në këtë formë.

Padyshim se e përkrahim integrimin e qytetarëve serbë të Kosovës në jetën institucionale dhe ne duhet t'i inkurajojmë që të bëhen pjesë e shtetndërtimit, të zhvillimeve demokratike dhe integriteteve euro-atlantike.

Edhe në fushën e sigurisë ne duhet t'u garantojmë qasje në vendimmarrje, zhvillim, e ekzekutim, por vetëm për ata qytetarë që e ndjejnë Kosovën për atdhe të vetin, me Kushtetutën, ligjet dhe vlerat e saj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka Rexhep Selimi.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Prezenca e Kabinetit qeveritar tani, megjithëse i zvogëluar, ndryshon prej asaj të para ditës, që munguan totalisht në seancën e para ditës, e në atë seancë së paku do të duhej të ishin ministri i Drejtësisë dhe ministri i Jashtëm, të cilëve Kuvendi u dha mandat dhe u dha detyra po pse jo edhe ish kryeministri i Kosovës, për të cilin ishte tema. Por si do qoftë, unë po kthehem edhe një herë në temën që trajton kjo seancë e mbrëmjes.

Kaq energji sa po harxhon Qeveria për të na bindur se sa të nevojshme janë raportet me Serbinë dhe normalizimi i tyre do të duhej që këtë energji Qeveria ta shpenzonte në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës, i cili sovranitet po shkelet së paku nga njëra palë



bashkëbiseduese, siç është Serbia, e në të shumtën e rasteve nga të dyja palët bashkëbiseduese.

Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë abnormalizon marrëdhëniet e Qeverisë me qytetarin e Kosovës, sepse interesi i qytetarëve të Kosovës është i kundërt dhe i ndryshëm me interesat që i ka Serbia, prandaj të dyja nuk do të mund të arrihen asnjëherë.

Duke parë se sa po normalizohen marrëdhëniet e Qeverisë me Serbinë determinon edhe raportin se sa është normal i Qeverisë së Kosovës me qytetarin e Kosovës, pra kjo determinon raportin e Qeverisë me qytetarin e Kosovës.

Por, si shumë hera tjera, edhe me 17 Shkurtin e këtij viti që e lamë pas, por jo vetëm me këtë 17 Shkurt dhe jo vetëm në këtë datë, Qeveria e Kosovës shkon në Prekaz për të marrë, siç thotë, energji të reja. Ku jeni duke i shpenzuar këto energji, të nderuar qeveritarë?

15-vjetori i Epopesë së Jasharëve nuk do të duhej ta gjente Qeverinë në bisedime me Serbinë. Aq më keq, me Daçiqin, zëvendësin e atij që shkaktoi terror mbi shqiptarët në përgjithësi e që vrau Jasharët para 15 vjetësh në veçanti. Ky Daçiq, pra ishte ai që numëronte me krenari të vrarët në Kosovë nëpër konferenca shtypi si zëdhënës i Milosheviqit.

Prandaj, kryeministër, nëse të ka ngelur edhe pak nga ajo energji që ke marr para dy javësh në Prekaz, mos shko ta harxhosh me Daçiqin, ose harxhoje në të mirë të këtij vendi ose ktheje aty ku e more. Nuk harxhohet energjia e marrë në Prekaz duke i shtrënguar duart me Daçiqin. Në mes të takimit me Ivica Daçiqin në Bruksel dhe të takimit me Rifat Jasharin në Prekaz, do të duhej ta zgjidhnit këtë të dytën, së paku në 15-vjetorin e Epopesë së Jasharëve dhe të UÇK-së. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

**GANIMETE MUSLIU:** I nderuar kryetar i Kuvendit, I nderuari kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar, Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë, Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, Jemi të gjithë të vetëdijshëm që Kosova po kalon momente shumë historike dhe janë momente delikate për Kosovën dhe qytetarët e Republikës së Kosovës kanë plotësisht të drejtë që të jenë të shqetësuar dhe të dinë të informohen se çka është duke ndodhur në Kosovë, sepse thënë të drejtën janë terrorizuar nga opinionet mediale që çdo ditë flitet me apo pa kompetencë për dialogun që është duke ndodhur në Bruksel.

Më lejoni që me këtë rast të përshëndes t, gatishmërinë tuaj zoti kryeministër për transparencën e plotë që po tregon me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe po tregoheni i gatshëm kurdoherë që qytetarëve të Kosovës t'ia bartni informacionin dhe t'i njoftoni me kompetencë, me përgjegjësi të lartë, me atë çka ju dha sovranin dhe ju dha këtë mandat edhe të Kosovës që thjesht ta përfaqësoni Kosovën edhe në këtë dialog.

Ndihem jashtëzakonisht mirë si deputete e Parlamentit të Kosovës, e mbi të gjitha si qytetare e Kosovës kur flitet për kushtet dhe normalizimin e jetesës në veri të Mitrovicës, për sigurinë e atyre qytetarëve, për mundësitë e integritit të atyre qytetarëve në shoqërinë tonë në Kosovë, në institucionet e Kosovës, por megjithatë dua edhe një herë që të apeloj dhe t'i drejtohem qytetarëve të veriut të Kosovës me theks të veçantë, dua t'u drejtohem serbëve të Kosovës, që të jenë më konstruktiv, të jenë më bashkëpunues dhe më mirënjohës, ta njohin shtetin e Kosovës dhe mos ta luajnë rolin e "Vetëvendosjes" që të marrin të gjitha benificionet, të gjitha të mirat që i ofron shteti i Kosovës dhe të mos e njohin Kosovën, të mos e njohin Kushtetutën e Kosovës, të mos i njohin simbolet e Kosovës, të mos e pranojnë himnin e Kosovës. Kosova ka për obligim, institucionet e Kosovës kanë për obligim që të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim t'u ofrojnë garanci, t'u ofrojnë bashkëjetesë, t'u ofrojnë siguri në Kosovë. Ne si shqiptarë në këtë rast që jemi shumicë e kemi për obligim që serbëve kudo që janë, qoftë në veri, qoftë në jug t'u shtrijmë dorën, t'u ofrojmë bashkëjetesë dhe mos u dëshirojmë atë çka nuk e kemi dëshiruar ne me vite të tëra, atë çka na kanë ofruar neve serbët në vite të tëra para luftës në Kosovë. Kosova po dëshmon çdo ditë që është e gatshme që të bashkëpunojë me të gjitha shtetet në rajon, edhe me Serbinë, gjithmonë si dy shtete fqinje dhe këtë rrugë duhet ndjekur në vazhdimësi.

Populli i Kosovës di të çmojë bashkëpunimin, di të çmojë unitetin, prandaj kërkoj nga ju zoti Kryeministër që të mos hezitoni të dilni edhe në komunat e Kosovës dhe t'u ofroni qytetarëve sa herë që ata kanë nevojë që të informohen për rrjedhat e dialogut dhe për procesin që është duke vazhduar.

Para se ta përfundoj, dua të them për qytetarët e Kosovës se jemi në rrugë të drejtë dhe dua të falënderoj, edhe një herë dua të përshëndes anëtarësimin e Kosovës në bashkëpunim rajon, që është edhe një sukses i arritur i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ju si Kryeministër i Kosovës. Faleminderit!

**KRYTARI:** Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar nënkryetar,

Kolegë deputetë,

Një përshëndetje për Kabinetin qeveritar i cili arriti të vijë në sesionin e mbrëmjes për deri sa në mëngjes mungoi plotësisht.

Gjithashtu, përshëndetje për koordinatorin, i cili nuk është këtu. Me siguri është duke i koordinuar bisedimet dhe prej të cilit nuk kemi dëgjuar asgjë për koordinimin. Me siguri është shumë i zënë me punë, prandaj nuk po arrin t'i adresohet dhe ta informojë Kuvendin.

Mendoj që duhet të dihet që LDK-ja e ka pranuar rezolutën, ndonëse si opozitë, zoti kryeministër ju tregonit se edhe ju e keni pranuar, edhe LDK-ja e ka pranuar rezolutën dhe i ka dhënë kompetenca Qeverisë për biseda.

E ka pranuar Rezolutën dhe në pikën 5 thotë që marrëveshjet të sillen në Kuvend për ratifikim, gjë e cila ju jep fuqi, zoti kryeministër juve dhe Qeverisë për biseda dhe ju mbron nga presionet dhe nuk ju len që gjithë barrën dhe vendimet e vështira t'i merrni vetëm ju, sepse e keni edhe Kuvendin prapa. Edhe kjo tregon respektin për institucione dhe përgjegjësinë e LDK-së ndaj shtetit të Kosovës.

Na e dimë që bisedimet nuk janë të lehta, prandaj edhe presim nga ju kryeministër një qasje ndonjë raportim real, pa pasur nevojë për zbulime të gjërave, prandaj deklarimet se do të kemi njohje reciproke të Kosovës dhe Republikës së Serbisë nuk janë deklarime të cilat duhet t'i thoni këtu në Kuvend, sepse jemi bashkë në atë proces. Apo, po ju kujtoj qysh thoshit përpara: Ambasada e Republikës së Kosovës në Beograd, tash u kthye në Zyra Ndërlidhëse e cila do të vendoset në objektet e Bashkimit Evropian, në Beograd dhe në Prishtinë.

Në ndërkohë, Daçiçi, në anën tjetër, thotë: Kurrë nuk do ta njohim Kosovën, kur nuk do të ketë ambasada, nuk na duhen asociacionet pa fuqi ekzekutive dhe desha t'ju pyes ajo leja për ndalesa për kamionë 3,5 tonë, ajo po vazhdon kryeministër, ndonëse keni premtuar që kjo çështje do të rregullohet.

Daçiçi thotë se strukturat paralele vetëm do të ristrukturohen apo ripaqetohen, por për dallim tash do të jenë në barrë të buxhetit të Kosovës e jo në barrë të buxhetit të Serbisë, prandaj mendoj që i kemi bërë një nderë Serbisë që ia kemi hequr këtë barrë të buxhetit.

Ju garantuat se asociacioni do të jenë sipas Ahtisarit, pa fuqi ekzekutive e legjislative, ashtu qysh thotë në nenin 10 të Ahtisarit, edhe në ligjet që do të jenë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit lokal. Po zoti kryeministër kjo është në ligjet tona, çka ka pasur nevojë të shkohet dhe të bisedohet për diçka e cila është e garantuar. Pse do të duhej që të bisedohet me një shtet tjetër për diçka që është plotësisht e garantuar me ligjet tona dhe me dokumentin e Ahtisarit, të cilin shumë herë e përmendën sot.

Ju po thoni se zgjedhjet do të mbahen sipas ligjet e Kosovës dhe me të vërtetë na bërët të lumtur me atë, po a do të bëhen me letërnjoftimet e Serbisë apo me letërnjoftime të Kosovës, zoti kryeministër?

Strukturat do të shpërbëhen dhe t'u ndalohet interferimi nga Serbia. Dhe, deklarimi tjetër që integrimi në EU, në NATO, në OKB, këto janë garanci shumë të fuqishme të cilat do të kishin bërë të lumtur po të kishin qenë reale. Por deri më tani nuk e sollët asnjë marrëveshje për të cilën thatë se janë arritur.

Bile, zëvendëskryeministri Kuçi tha se do të përfundojnë bisedat në marrëveshje me shkrim në mes të Kosovës, Serbisë dhe Eshtonit. Aty ju harruat ta thuani. Po më duket që ua rikujtoi zoti Kuçi apo ishte aty për aty, ad hoc edhe një plotësim.

Prandaj, ne që jemi pak më herët në këtë Parlament e dimë se dokumenti i Ahtisarit ka qenë një dokument i vështirë dhe kemi thënë që funksionalisht shteti i shtetit do të dëmtohet në qoftë se shkohet me Ahtisarin plus. Prandaj, presim prej jush jo vetëm që të

jeni vetëm aty dhe që të merrni vendime të rënda, se nuk jeni vetëm, na keni edhe neve, po me të vërtetë të na jepni përgjigje si e keni menduar këtë asociacionin, apo zgjedhje apo strukturat, këto janë pyetje të cilat kisha pasur dëshirë të kenë përgjigje prej jush. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Pasi që veç u bë ora 23:00 dhe nuk e di që Kuvendi i Kosovës të ketë debatuar ndonjëherë më parë në seancë në orë kaq të vona.

U thanë shumë çështje dhe shumë çështje me vend, mirëpo pati edhe të tilla pa vend, mirëpo si do që të jetë, mbetet ndërgjegjja e secilit për ato çfarë ka diskutuar veç e veç gjithsecili.

Unë do të provoj të jem shumë i shkurtër, prandaj i nderuar kryetar, i nderuar kryeministër, të nderuar deputetë, Rezoluta e votuar në Kuvend për normalizimin e raporteve me Serbinë është bazë ligjore dhe juridike për zhvillimin e këtyre bisedimeve.

Ashtu është obligues edhe raportimi, andaj askush nuk ka të drejtë të na mohojë këtë të drejtë ligjore dhe kushtetuese si ndodhi dje.

I nderuar kryeministër,  
Dua t' ju falënderoj për gatishmërinë tuaj për të na informuar në këto orë të vona për zhvillimin e bisedimeve në Bruksel.

Ne dhe qytetarët e Republikës së Kosovës kemi besim të plotë në ju, sepse në të gjitha takimet keni dëshmuar aftësi të shkëlqyeshme dialoguese në mbrojtje të interesit të vendit si në Rambuje, në Vjenë dhe në vitin 2008 me rastin e shpalljes së pavarësisë së vendit.

Këto aftësi dhe virtyte tuaja dialoguese kanë bërë që edhe vetë kryeministri i Serbisë Ivica Daçiq, këto ditë të shprehë publikisht pakënaqësinë e tij për ecurinë e bisedimeve se ato nuk po shkojnë në favorin e Serbisë, edhe pse këtu një grup i vogël deputetësh janë të pakënaqur se Serbia nuk po arrin të realizojë synimet e saj dhe me këtë po u ngushtohet edhe hapësira e tyre vepruese dhe kanë filluar me veprime të tyre performuese.

Duke dëgjuar pak më parë fjalimin e Visar Ymerit, i cili fliste duke shikuar Albin Kurtin dhe kolegët e tij duke qeshur, fillova të krijoj një përshtypje sikur se jam në një shfaqje humori apo cirku, ku Palaço e Ymeri po performonte, ndërsa audienca e tij po qeshte.

Verimet e tij nuk janë të denja për një parlamentar, me fjalimin e tij me përmbajtje qesharake. Si do që të jetë, mbetet në ndërgjegjen e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Siç shihet, të gjithë janë disponuar tash, meqë jam i fundit, dhe nuk do ta zgjas shumë.

I nderuar kryetar,  
Kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Dhe ju deputetë,

Mendoj se është një temë e cila është duke u diskutuar më shumë nga një aspekt i cili nuk paraqet realitete se sa duke shpjeguar rezultate të arritshme nga koha kur në veriun e Mitrovicës kanë filluar qasja e Qeverisë së Kosovës dhe përkrahja jonë si deputet që iu ka bërë Qeverisë së Kosovës në qasjet që është bërë për ndërhyrje dhe për ndërkombëtarizimi në çështjes së veriut, sepse ka qenë një pjesë e cila në një formë nuk është prekur asnjëherë nga askush, mirëpo në këtë parlament ne kemi dëgjuar shpeshherë se s'është arritur asgjë.

Është jo e drejtë për shembull që sot të themi ne këtu kemi diskutuar fillimisht kur ka filluar IBM, nga ju që keni përfunduar juridikun e deri te ata të marrëdhënieve ndërkombëtare, unë kam pasur befasi të shumta dhe unë falënderoj disa deputetë këtu që mua më kanë sqaruar dhe na ka dalë ashtu siç është përgatitur sot Kosova në relacion kufitar me Serbinë, i ka katër pika kufitare të menaxhueshme dhe funksionale me Serbinë.

Ne kemi ardhur në konkludim që për 12 vjet ka qenë një kriminalitet i zhvilluar në atë rajon, i dhunuar nga një grup i banditëve që ka qenë i instrumentalizuar edhe nga politika e Serbisë dhe i cili ka qarkulluar mbi 7 miliardë euro për 12 vjet dhe normalisht që shqetësimet do të jenë në dy taborët rajonale fizike edhe në veri po edhe në Serbi, sepse kanë humbur shumë interesa të mëdha jetike dhe meskine.

Prandaj në këtë pikë ne duhet t'i shohim realisht çështjet dhe të dalim në pjesën e integritit. Në pjesën e integritit unë mendoj nuk dëgjova asnjë këtu se në çfarë mënyre përveç zëvendëskryeministri i cili dha qartësim në çfarë forme do të funksionojnë që duke filluar edhe nga pjesa e drejtësisë po edhe nga pjesa e integritit të sigurisë.

Dikasteret të cilët do të fillojnë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas ligjeve në fuqi për pushtetin lokal, ato do të funksionojnë me ato forma dhe të cilat janë të garantuara me të gjitha dokumentet sot valide që janë edhe transparente.

Hipotetikusht që po thuhet se ne po dyshojmë në asociacionin se çka do të bëjmë është e drejtë e secilit të kemi frikë, edhe është e drejtë që të shtrojmë edhe pyetje. Mirëpo, deri sa i kemi dy institucione më të fuqishme ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian si garantues dhe ndërmjetësues të kësaj bisede, neve na japin të drejtën e plotë të çdo reagimi me çdo formë duke shti në një formë një lloj dorëzanie ndërkombëtare e cila e garanton atë formë të funksionimit në atë pjesë të Republikës së Kosovës.

A do ketë probleme të tilla të cilat ne sot jemi duke i parë, është e vërtetë se po, mirëpo unë mendoj dhe jam i bindur se nuk është mirë që të shihet vetëm zi si çështje që nuk do të funksionojë, një pjesë e deputetëve këtu me një romantizëm të kaluar dhe me një formë e cila nuk jep asnjë formë zgjidhjeje por vetëm konkluduese se çka u fol pa e folur edhe realitetin, nuk besoj se u bën nderë e dhe ” vlerave të tyre patriotike” duke u munduar se të gjithë tjerët janë keq përveç neve që jemi mirë.

Unë përkrah çështjen e dialogut, kam përkrahur vazhdimisht. Ne kemi obligim të kërkojmë që kryeministri i Kosovës në këtë dialog u cili është duke shkuar drejt zgjidhjes përfundimtare të problemeve të krijuara të jetë në formën e një ratifikimi të çdo marrëveshjeje je cila është tash në kohën më të shpejtë dhe e cila është duke ardhur në përfundim e në kurorezim dhe të jemi më të informuar si qytetarë dhe të mos të lejojmë hapësira për disa individë të cilët mendojnë t’i kapitalizojnë për konsum të brendshëm.

Unë e kam parë Parlamentin edhe të Serbisë dhe në të njëjtën mënyrë e kanë cituar për shembull që kryeministri i Republikës së Kosovës, edhe me Kosovën nuk bisedohet dhe me kriminelët e Kosovës, nuk bisedohet. Prandaj, një paralelizëm i tillë tregon më shumë humbjen e interesave personale se sa ruajtjen e përmbytjes nacionale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Po shpresojmë se diskutuesi i fundit do të jetë deputeti Salih Morina. Ka premtuar se do të flasë shkurt.

**SALIH MORINA:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë u diskutua dhe debatua mjaft lidhur me këtë raportim që e bëri kryeministri i Kosovës, unë personalisht i kam dy pyetje, e para ka të bëjë me numrin e marrëveshjeve të cilat janë përmendur dhe arritur deri më tani dhe kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e Lidhjes Demokratike, pse këto marrëveshje, do të thotë, nuk po ratifikohen pasi që është edhe obligim kushtetues, sepse marrëveshjet janë arritur në saje të dy shteteve, dy shteteve sovrane dhe kërkesa jonë ka qenë që këto marrëveshje duhet të sillen në Parlamentin e Kosovës dhe njëkohësisht këto marrëveshje duhet të ratifikohen dhe pyetja tjetër ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, fetare me theks të veçantë të asaj serbe.

Nga ana e kryeministrit në këtë Parlament do të thotë është raportuar gjithmonë që është shpreh kjo temë e cila është shumë e rëndësishme, e po ashtu edhe nga ana e zëvendëskryeminstres dhe unë desha të di që në kuadër të kësaj marrëveshje, Qeveria e Kosovës ka arritur të formojë njësitet e veçanta të Policisë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore por mua personalisht po më intereson dhe besoj edhe qytetarëve të Kosovës që a është diskutuar ndonjëherë për kthimin e artefakteve, që është një numër i konsiderueshëm që në këtë dhjetëvjetëshin para luftës do të thotë janë plaçkitur dhe marrë nga ana e Serbisë.

Prandaj, kisha dashur të kemi ndonjë përgjigje lidhur me këto dy pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, diskutimet kanë përfunduar. Kryeministri, nëse e do fjalën për t'u përgjigjur në pyetjet, mund ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryeparlamentar, Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë, Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës, Të nderuar deputetë, Unë ju falënderoj shumë për diskutimet, Ju falënderoj që u krijua kjo mundësi për të diskutuar, për t'u informuar edhe ju drejtpërdrejt, për t'u informuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës deri në detaje për gjithçka çka është duke ndodhur. Unë ju zotohem se për çdo hap të mëtutjeshëm do të informohet Parlamenti i Republikës së Kosovës, do të informohen qytetarët e Republikës së Kosovës, do të informohen mediat, shoqëria civile dhe i gjithë opinioni publik kosovar.

Pasi që sonte më tepër e kemi plotësuar njëri-tjetrin, unë dëshiroj t' ju falënderoj të gjithëve, ju deputetë të mazhorancës, ju deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, prandaj më lejoni në emrin tim personal dhe të Qeverisë së Kosovës, t'u falënderoj për këtë debat konstruktiv, korrekt dhe në shërbim të proceseve tona konsoliduese të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*